

Projekti Rrjeti 23+
është finansuar nga
Bashkimi Europian

RAPORTI NË HIJE PËR KAPITULLIN 23

maj, 2016



ХЕЛСИНШКИ
КОМИТЕТ ЗА ЧОВЕКОВИ
ПРАВА НА РЕПУБЛИКА
МАКЕДОНИЈА

МРЕЖА

23

Raporti në hije për Kapitullin 23

Përperiudhën korrik 2015 - prill 2016

Botues:

**Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë
i përfaqësuar nga presidenti prof. dr. Gordan Kallajxhiev**

Redaktore:

**dr. Malinka Ristevska Jordanova
Uranija Pirovska**

Autorë:

**Neda Čalovska
dr. Voislav Stojanovski
mr. Aleksandar Jovanovski**

Përkthimi:

Jordana Shemko-Georgievska

Përpunimi teknik i shtypjes:

Gaja Dizajn

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

342.72/73(497.7)(047)

34.03(497.7)"2015/2016"(047)

ČALOVSKA, Neda

Raporti në hije për Kapitullin 23 / Neda Čalovska, Voislav
Stojanovski, Aleksandar Jovanoski. - Shkup : Komiteti i Helsinkit për
të Drejtat e Njeriut i RM, 2016. - 56 стр. ; 26 см

ФУСНОТИ КОН ТЕКСТОТ

ISBN 978-608-4790-09-9

1. Stojanovski, Voislav [автор] 2. Jovanoski, Aleksandar [автор]
а) Човекови права и слободи - Македонија - 2015-2016 - Извештаи б)
Судство - Партиски влијанија - Македонија - 2015-2016 - Извештаи
COBISS.MK-ID 101116426

Ky publikim është mundësuar me mbështetje nga Bashkimi Evropian në suazat e Projektit “Rrjeti 23+” të cilin e implementon Instituti për Politikë Evropiane (IPE) - Shkup dhe Komiteti I Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Mendimet e dhëna në këtë publikim janë mendime të autorëve dhe nuk i shprehin gjithmonë mendimet e Bashkimit Evropian.

■ Listë e shkurtesave

AQIMLGj - Sistem automatik informativ për menaxhimin me lëndët gjyqësore
OBRM PDBNM - Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Bashkim Nacional Maqedonas
GShLK - Grupi i Shteteve për Luftë kundër Korrupsionit
OQM - Opsioni Qytetar për Maqedonisë
DMDhP - Drejtoria për Mbrojtje të të Dhënave Personale
KShZ - Komisioni Shtetëror Zgjedhor
KEDNj - Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KE - Komisioni Evropian
IPE - Instituti për Politikë Evropiane
GjEDNj - Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
BE - Bashkimi Evropian
LPP - Ligji për Procedurë Penale
PRU - Prioritetet Reformuese Urgjente
NP - Ndërmarrja Publike
KP - Kodi Penal
ShDE - Shtëpia Dënuese-Edukuese
KTS - Komiteti Evropian për Ndalim të Torturës dhe Sjelljes apo Dënimit Çnjerëzor ose Ofendues.
PLD - Partia Liberale Demokratike
Bashkësia LGBTI – Bashkësia Lesbike, Gej, Biseksuale, Transgjimore dhe Interseksuale
MEQR - Maqedonia BE Qendra e Resurseve
MPB - Ministria e Punëve të Brendshme
MPPS - Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
KMH - Komiteti i Helsinki për të Drejtat e Njeriut në RM
PRSD - Partia e Re Socialdemokratike
OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara
MKO - Marrëveshja Kornizë e Ohrit
PARIP - Drift-plani i aktiviteteve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i përgatitur në bazë të listës së Prioriteteve Reformuese Urgjente për Republikën e Maqedonisë
PLT - Partia për Lëvizje të Turqve
RM - Republika e Maqedonisë
LSDM - Lëvizja Socialdemokratike e Maqedonisë
KE - Këshilli I Evropës
SMB - Sektori për Mundësi të Barabarta në MPPS
PPS - Prokuroria Publike Speciale (Prokuroria Publike për Ndjekjen e Veprave Kriminale që lidhen me përmbajtjen dhe dalin nga përmbajtja e ndjekjes joligjore të komunikimeve)
KGJRM - Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë
DSK - Drejtoria për Sigurim dhe Kundërzbulim
UPOZ - Sindikata e Drejtorisë, Gjyqësorit dhe Shoqatave të Qytetarëve

Përmbajtje:

Hyrja	7
Metodologjia	9
Gjykata Kushtetuese	10
1. Gjyqësori	12
<i>Strategjia për reformë të gjyqësorit 2016-2020</i>	13
Pavarësia	14
<i>Prokuroria Publike Speciale</i>	16
Paanshmëria dhe përgjegjësia	19
Profesionalizmi, specializimi dhe efikasiteti	23
<i>Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë</i>	23
<i>Shërbimi gjyqësor</i>	24
2. Lufta kundër korrupsionit	26
Komisioni Shtetëror për Pengim të Korrupsionit	26
<i>Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve</i>	27
3. Të drejta themelore	28
Të drejtat e njeriut	28
Avokati i Popullit	28
<i>Tortura dhe lloji tjetër i veprimit ose dënimit të ashpër ofendues apo çnjerëzor</i>	28
<i>Burgje dhe paraburgim</i>	30
<i>E drejta e respektimit të jetës private dhe familjare dhe komunikimeve</i>	32
<i>Liria e tubimit dhe shoqërimit</i>	34
<i>Grupet e lëndueshme dhe parimi i mosdiskriminimit</i>	36
<i>iria e shprehjes dhe pluralizmit në media</i>	39
<i>E drejta e arsimit</i>	42
<i>E drejta e pronësisë</i>	43
<i>Barazia gjinore dhe të drejtat e grave</i>	43
E drejta prodedurale	46
<i>Liria dhe siguria</i>	46
Mbrojtja e pakicave dhe të drejtave kulturore	47
Masa kundër racizmit dhe ksen ofobisë	49
Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	51
Bibliografi:	52
Ueb-faqet e përdorura:	56

■ Hyrja

Qëllimi themelor i projektit “Rrjeti 23 +” që realizohet nga Instituti për Politikë Evropiane – Shkup dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë, është kontribut i strukturuar në shoqërinë qytetare në ndjekjen dhe vlerësimin e politikave të përfshira në Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore.

Ky raport është përmbledhje e përfundimeve dhe rekomandimeve në bazë të ndjekjes së fushave të strukturuar në Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore. Raporti ishte përgatitur në kushte të krizës së thellë politike si rezultat i zbatimit të pasuksesshëm të Marrëveshjes së Përzahinos dhe moszbatimin e pikave të tij kryesore lidhur me prioritetet reformuese të cilat ishin përcaktuar në bazë të Raportit të Pribes.

Ajo që del kryesisht si përfundim për fushat në vijim është ende e pranishme dhe në periudhën e fundit është përforcuar kontrolli mbi gjyqësorin dhe institucionet shtetërore me qëllim që të pengohet përcaktimi i gjendjeve, të jepet mbrojtja përkatëse dhe të zbatohen procedurat ligjore që do të çonin në rezultate të drejta, kurse me të edhe një hap përpara në zbatimin e reformave dhe sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në vend. Manifestimi i këtij diskursi kryesisht reflektohet në mungesën e transparencës në procedurat, procedurat urgjente për miratimin e ligjeve të rëndësishme pa përfshirjen e aktorëve kryesorë në shoqëri, zgjedhjen e gjykatësve dhe funksionarëve të tjerë të lartë në bazë të përkatësisë së tyre politike, pengimin e punës së Prokurorisë Publike Speciale dhe në fund keqpërdorimin e drejtpërdrejtë të Gjykatës Kushtetuese nga pozita e Presidentit të shtetit, si instrumente për arritjen e qëllimeve të pushtetit.

Të gjithë këta faktorë vetëm e vërtetojnë konstatimin se nuk ekziston ende ndarje e shtetit nga partia, që ishte një nga konstatimet e Raportit të Pribes. Infektimi i institucioneve nga pushteti, prodhon sistem pa ndëshkime ose drejtësi selektive kur bëhet fjalë për kundërshtarët e saj apo për kritikuesit e rregullt. Paraburgimi edhe mandej zbatohet si dënim në raste të ndryshme politike, por jo edhe për ata të cilët janë pjesë e strukturës në pushtet që vjen në shprehje në procedurat që janë ngritur nga Prokuroria Speciale Publike dhe refuzimi i kërkesave për paraburgim nga ana e gjykatës. Nga ana tjetër, pengimi dhe pamundësimi i punës së këtij organi, është përforcuar me vendimet për abolicion kolektiv të marrë nga Presidenti i shtetit, që është precedent në drejtësi, nëse merret parasysh se me këtë akt ai u vu mbi Kuvendin dhe veprimi në bazë të dispozitave të cilat nuk kanë veprim juridik. Zhvillimi i tillë i ngjarjeve vetëm kontribuoi në ndjenjën e pasigurisë të qytetarët nëse merret parasysh se mosbesimi të institucioneve dhe sidomos në gjyqësor në periudhën e fundit është në një nivel të lartë. Perceptimi i tillë gjithsesi bazohet dhe te mungesa pothuajse e tërësishme e përgjegjësisë dhe ligjshmërisë së veprimit të institucioneve dhe gjykatave në vitet e kaluara. Prandaj, të drejtat e njeriut dhe sistemi i mbrojtjes së tyre janë vendosur në margjinat që vërehet edhe në funksionimin e institucioneve ndëshkuese-përmirësuese dhe institucionet edukuese-përmirësuese në shtet, ku regjistrohen ende raste të torturës dhe mosndëshkimit të kryerësve të këtyre veprave, kushte johumane ku mbahet masa paraburgim dhe dënimi me burg dhe mungesa e programeve të resocializimit dhe riintegritit, si dhe arsim për kryerës minorenë të veprave penale.

Diskriminimi i cili vite me radhë jepet si pikë për shqetësim për shkak të sistemit jo të mirë të mbrojtjes, përsëri u bë objekt diskutimi pas përzgjedhjes së kryetarit të ri dhe anëtarëve të Komitetit për Ndalimin dhe Mbrojtjen e nga Diskriminimi, persona të cilët jo vetëm që nuk posedojnë përvojë pune në këtë fushë mjaft të ndjeshme, njëkohësisht janë edhe persona të cilët lidhen drejtpërdrejt me partitë politike në pushtet. Nëse merret parasysh fakti se një prej kushteve kryesore për veprimin përkatës të këtij Komisioni është pavarësia e tij, atëherë është e qartë se pyetja për funksionimin e mëtejshëm të saj si aktor relevant në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, është objekt i shqetësimit serioz. Kjo edhe më tepër për faktin se Republika e Maqedonisë vite me radhë tregon paaftësi reale që të ballafaqohet me diskriminimin ndaj grupeve të caktuara të qytetarëve, sidomos me diskriminimin e përfaqësuesve të bashkësisë LGBT. Deri më sot, kryerësit e sulmeve mbi Qendrën LGBT për mbështetje nuk janë gjetur, kurse nuk ka as informacione se a kryhet ndonjë hetim. Në këtë drejtim, si faktor kryesor gjithsesi është mungesa e vullnetit politik, që u dëshmuua si fakt dhe kur bëhet fjalë për Ligjin për Pengim dhe Mbrojtje të Diskriminimit, ku orientimi seksual nuk është përcaktuar si bazë për diskriminim edhe përkrah rekomandimeve të shumta në disa raporte të BE-së për përparimin e RM-së.

Diskursi i përforcuar i okupimit të hapësirës së lirë për informim objektiv gjithsesi se ka ndikuar seriozisht dhe në lirinë e shprehjes dhe lirisë së shoqërimit, për çka flasin edhe sulmet e shumta mbi gazetarët e lirë, aktivistët dhe organizatat qytetare për shkak të reflektimit të tyre kritik ndaj partive politike. Pengimi i qytetarëve që ta shprehin lirisht revoltën e tyre në protestat që filluan të organizohen më 13 prill 2016, kulminuan me arrestimin e aktivistëve me çka u përsërit skenari i vitit të kaluar, me përcaktimin e masave arrest shtëpie, që do të kishte si qëllim pamundësimin e tyre të marrin pjesë në protesta.

E gjithë kjo flet për mungesën pothuajse të tërësishme të parimeve të cilat e përcaktojnë mbizotërimin e të drejtës në një shtet, mungesën e ndarjes së pushtetit për shkak të ndikimit dominues të pushtetit ekzekutiv dhe bllokadës së tërësishme të sistemit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Ky raport është kontribut i organizatave qytetare në fushat ku është e rëndësishme të fillohet me zbatimin e reformave dhe duhet të shërbejë si drejtues në ripërcaktimin jo vetëm të kriterëve të vlerave të cilat duhet të jenë pikë filluese e këtij procesi.

■ Metodologjia

Për realizimin e raportit është kryer metodologjia për ndjekjen e fushave të cilat janë fokus i punës së Rrjetit 23 – gjyqësori, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore e cila përfshin përdorim të qasjes së lirë të informacionet e institucioneve relevante, mbajtjen e grupit të fokusit me shoqatat e qytetarëve të cilat punojnë në këto fusha dhe punëtoria tematike eksperte ku morën pjesë shoqata të qytetarëve, institucione dhe gjykatës të mëparshëm. Janë shfrytëzuar edhe të dhëna, analiza dhe brifingje mujore të përgatitura nga shoqatat e qytetarëve të cilat janë pjesë e Rrjetit 23.

Kërkesat për informacione me karakter publik janë dërguar te të gjitha gjykatat themelore dhe prokuroritë publike në shtet, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë, Gjykata Administrative e Republikës së Maqedonisë, Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, Akademia e Gjykatës dhe Prokurorëve publik, Avokati i Popullit, Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Korrupsioni, Agjencia për media audio dhe audiovizuale, Komisioni Shtetëror për Pengim të Korrupsionit, Drejtoria për Mbrojtje të të Dhënave Personale, Këshilli Shtetëror për Parandalim të Delikuencës së të Miturve dhe Drejtori për Zbatim të sanksioneve. Përgjigje nuk kanë dorëzuar katër gjykata, një prokurori publike dhe Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publik.

Grupi i fokusit kishte për qëllim t'i përfshijë shoqatat relevante të qytetarëve të cilët punojnë në fushat: gjyqësor, luftë kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore në përgatitjen e raportit, nëpërmjet përfshirjes së të dhënave të cilat i kanë marrë nëpërmjet ndjekjes së fushave të dhëna. Në grupin e fokusit i cili u mbajt më 26.02.2016 morën pjesë dymbëdhjetë përfaqësues nga shoqatat e qytetarëve të dhëna më poshtë: Instituti për të Drejtat e Njeriut, Koalicioni “Të gjithë për gjykim të drejtë”, Shoqata e Punëtorëve Financiarë në Vetëqeverisjet Publike dhe në Ndërmarrjet Publike; Fondacioni Shoqëria e Hapur Maqedonia, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Qendër Forumi për Hulumtime Strategjike dhe Dokumentim; Transparencë Maqedoni; Transparensi Interneshënël; Instituti për Demokraci; Fondacioni Metamorfozis, Shoqata Maqedonase për Juristë të rinj; Asociacioni për Iniciativa Demokratike. Ky fokus grupi bazohet në një pyetësor të përgatitur nga autorët e raportit, kurse të dhënat dhe konstatimet e marra nga shoqatat e qytetarëve janë përfshirë në këtë raport.

Punëtoria tematike eksperte, ku morën pjesë ekspertë relevantë, duke përfshirë edhe gjykatësit e mëparshëm, megjithatë dhe përfaqësues të institucioneve, u mbajt më 18.04.2016. Pjesëmarrësit në punëtorinë tematike patën mundësi të japin mendimin dhe rekomandimet e veta, duke u mbështetur me burime/dëshmi nga përvoja dhe veprimtaria në pjesën e gjyqësorit, luftës kundër korrupsionit dhe të drejtave themelore.

Raporti e përfshin periudhën nga fillimi i korrikut 2015 deri në fund të prillit 2016.

Gjykata Kushtetuese

Në periudhën nga viti 2011-2013 janë emëruar 5 gjykatës të rinj në Gjykatën Kushtetute, me çka ata tani e përbëjnë shumicën e gjykatësve në gjyq. Përzgjedhja e tyre e ngadalshme, sidomos për faktin se nuk kanë qenë të njohur paraprakisht dhe nuk mund të konsiderohen si “juristë të theksuar” siç obligon Kushtetuta, lidhet edhe me dyshimet për zgjedhjen e tyre politike. Domethënë, asnjë prej gjykatësve të rinj nuk ka titull shkencor magjistër apo doktor i shkencave, dhe as një lloj angazhimi tjetër akademik apo punime shkencore të botuara. Dy prej gjykatësve para se të zgjidhen për gjykatës kushtetues kanë qenë gjykatës në gjykata themelore, kurse një gjykatës kushtetues nuk ka aspak përvojë në drejtësi apo shkencën lidhur me këtë fushë, përkatësisht ka kryer funksione administrative dhe politike. Të gjithë gjykatësit e rinj ose nuk flasin gjuhë të huaj ose kanë vendosur se flasin “pjesërisht”.¹

Gjykata kushtetuese gjatë vitit 2015 dhe 2016 është kritikuar nga opinioni ekspert dhe i përgjithshëm, kurse për punën e saj kanë shkruar shpesh edhe mediat. Sipas statistikës së gjykatës, duket se besimi në këtë institucion shënon një rënie të shpejtë. Domethënë, në vitin 2011, Gjykata ka pranuar 236 lëndë, në vitin 2012 – 205, në 2013 – 170, kurse në vitin 2014 – 173. Kjo do të thotë se në periudhë prej 4 vitesh, gjykata ka shënuar një rënie në lëndët e pranuar prej 73%. Rënie ekziston edhe te dispozitat e ndërprera apo të shfuqizuara të ligjeve. Në vitin 2011 janë ndërprerë/shfuqizuar 22, në 2012 – 20, në 2013 – 11, në 2014 – 11, kurse në vitin 2015 vetëm 6. Është vënë re rënie e kërkesave të dorëzuara për mbrojtje të lirive dhe të drejtave të qytetarëve, kështu në vitin 2011 janë dorëzuar 23, në 2012 – 25, në 2013 – 22, kurse në vitin 2014 vetëm 13. Gjykata punon vetëm me 20 të punësuar dhe me buxhet prej pesëqind mijë eurosh.²

Gjatë muajit shkurt 2016 Gjykata Kushtetuese ka marrë dy vendime për të cilat në publik ka pasur reagime të fuqishme se vendimet e tilla nuk janë në mbrojtje të Kushtetutës dhe interesave të qytetarëve, por mbrojtje të interesit të koalicionit qeveritar. Vendimi i parë lidhet me iniciativën e deputetëve Pavle Trajanovit dhe Todor Petrovit për vlerësim të kushtetueshmërisë së vendimit për lëshimin e Kuvendit, për të cilin Gjykata Kushtetuese u vetëshpall si jokompetente dhe e ka hedhur poshtë këtë iniciativë. Në debatin publik në Gjykatën Kushtetuese u parashtrua pyetja a është Gjykata Kushtetuese kompetente të diskutojë për vendimin e tillë të Kuvendit, përkatësisht a është vendimi për lëshimin e Kuvendit akt i brendshëm, për të cilin Gjykata nuk ka kompetencë apo është akt i përgjithshëm për të cilin Gjykata, në përputhje me Rregulloren e Punës, ka kompetencë të marrë vendim. Mendimet e gjykatësve kushtetues ishin të ndara në raport me iniciativën e dorëzuar dhe një pjesë e tyre mendonin se vendimi i tillë i Kuvendit është erga omnes dhe ka të bëjë me të gjithë elektoratin, prandaj Gjykata Kushtetuese është kompetente të diskutojë. Megjithatë, shumica e gjykatësve konsiderojnë se Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë të veprojë për aktin konkret juridik të Kuvendit dhe morën vendim me të cilin u shpall se Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente, duke shpjeguar se nuk bëhet fjalë për një akt të përgjithshëm apo ligj dhe nëse Gjykata Kushtetuese ndërhyr në vendimin për lëshimin e Kuvendit, kjo do të thotë se në të ardhmen mund të ndërhyjë në çdo vendim të Kuvendit.

¹<http://www.ustavensud.mk/domino/WEBSUD.nsf/Strani/%D0%A1%D1%83%D0%B4%D0%B8%D0%B8?OpenDocument>

²<http://www.ustavensud.mk/domino/WEBSUD.nsf/Strani/%D0%97%D0%B0%20%D0%A3%D1%81%D1%82%D0%B0%D0%B2%D0%BD%D0%B8%D0%BE%D1%82%20%D1%81%D1%83%D0%B4%20-%D0%93%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D1%88%D0%BD%D0%B8%20%D0%98%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D0%B8?OpenDocument>

Më 15 mars 2016 Gjykata kushtetuese në seancë me dyer të mbyllura ka marrë vendim ta shfuqizojë Ligjin për Ndryshime dhe Plotësim të Ligjit për Amnisti (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 12/2009”). Me këtë vendim u hap rruga Presidenti i RM-së të mund të amnistojë persona të dënuar për vepra penale kundër zgjedhjeve. Ligji i shfuqizuar ishte bazë ligjore për ekzistimin e Komisionit për Amnisti.

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese nuk dha arsyetim pse dhe në çfarë mënyre është marrë vendimi për përjashtimin e publikut gjatë seancës. Edhe pse për përjashtimin e publikut duhet të vendosë shumica e gjykatësve kushtetues, publiku nuk ishte informuar se a është mbajtur dhe kur është mbajtur mbledhja e punës e gjykatësve kushtetues për përcaktimin e shkaqeve për mbylljen e seancës dhe marrjen e një vendimi të tillë jodemokratik ose përsëri a është marrë ai vendim vullnetarisht nga Kryetarja.

Veprimi urgjent i Gjykatës mbi iniciativën për vlerësim të kushtetueshmërisë së këtij ligji, të marrë në fillim të muajit shkurt 2016, menjëherë pas hapjes së hetimit të Prokurorisë Speciale Publike për mashtrime në zgjedhje kundër ministrave të mëparshëm, jep dyshim me bazë se Gjykata Kushtetuese punon në mbrojtje të interesave partiake të koalicionit qeveritar.

Përbërja e tanishme e Gjykatës Kushtetuese nuk ka kapacitet ta kryejë funksionin e vet kushtetues të mbrojtjes së kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë, që në masë të madhe ka të bëjë me anëtarët e rinj të zgjedhur të cilët nuk i plotësojnë kushtet për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese në përputhje me Kushtetutën. Besimi në të është zvogëluar theksueshëm, kurse vendimet e saj iniciojnë gjithnjë dhe më tepër ndërhyrje politike.

1. Gjyqësori

Prioritetet reformuese urgjente (PRU) në sferën e gjyqësorit, të përcaktuara na Komisioni Evropian në qershor të vitit 2015,³ ose nuk janë përmbushur ose aktivitetet e ndërmarra për përmbushjen e tyre nuk ishin të mjaftueshme për arritjen e qëllimeve të reformave. Në analizën e përgatitur nga Rrjeti 23,⁴ në bazë të ndjekjes së zbatuar për realizimin e PRU-së, u konstatua se “Në fushën e gjyqësorit në thelb nuk zbatohen. Si substitut i reformave ofrohet vetëm 'një ambalazh i butë reformues' i cili e kënaq formën, por jo dhe thelbin. Zbatohen vetëm aspekte të caktuara, më tepër teknike, të cilët kanë ndikim të kufizuar mbi pavarësinë dhe profesionalizmin e pritur.⁵ Kjo vërtetohet edhe nga shqyrtimi i prioriteteve të veçanta në fushën e gjyqësorit të cilat na dëshmojnë se ndërmerren veprime të cilat janë në kundërshtim me Prioritetet reformuese urgjente.⁶

Është e qartë nga Dokumenti i Punës i Qeverisë në 25 shkurt të vitit 2016,⁷ Qeveria parashikon një sërë aktivitetesh të cilat në mënyrë thelbësore nuk i përmbushin prioritetet reformuese urgjente siç është përzgjedhja e gjykatësve pa kriteret e ndryshuara dhe evidenca e tyre, shtyrja e realizimit të prioriteteve nëpërmjet analizave etj.⁸ Sektori qytetar së bashku me Rrjetin 23, në evenimentet e veta në suazat e mbledhjeve konsultuese të mbajtura nën patronazh të Sekretariatit për Çështje Evropiane paralajmëroi teknikizimin e masave të propozuara dhe mungesën e vizionit se si t'i afrohen reformës. Gjithashtu, u bë thirrje edhe për një mekanizëm të gjerë konsultues, sidomos në përfshirjen e përfaqësuesve të sferës së gjyqësorit për dhënien e masave sa më adekuate dhe sa më të sakta.

³http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150619_urgent_reform_priorities.pdf

⁴Instituti për Politikë Evropiane, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Instituti për të Drejtat e njeriut, Koalicioni të Gjithë për Gjykim të Drejtë dhe NVO Infocentar.

⁵Instituti për Politikë Evropiane, Itnite reformski prioriteti pobavni od restavriranjeto na nereformskite praktiki!, gjendet në:

<http://epi.org.mk/docs/Realizacija%20na%20Itnite%20reformski%20prioriteti.pdf>.

⁶Maqedonia-BE Qendra e Resurseve (MBQR 23), Statusi i realizimit të Prioriteteve reformuese urgjente. Gjendet në: <http://www.merc.org.mk/status-na-realizacija-na-itni-reformski-prioriteti>

⁷Drift-plan për aktivitetet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i përgatitur në bazë të listës së prioriteteve reformuese urgjente për Republikën e Maqedonisë (qershor 2015) PARIRP- 2015, gjendet në:

[http://www.sep.gov.mk/data/file/PARIRP/%D0%9F%D0%BB%D0%B0%D0%BD%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%B0%D0%BA%D1%82%D0%B8%D0%B2%D0%BD%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%B8%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%80%D0%B5%D0%B0%D0%BB%D0%B8%D0%B7%D0%B0%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%B8%D1%82%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%B5%20%D1%80%D0%B5%D1%84%D0%BE%D1%80%D0%BC%D1%81%D0%BA%D0%B8%20%D0%BE%D1%80%D0%B8%D0%BE%D1%80%D0%B8%D1%82%D0%B5%D1%82%D0%B8%202015%20\(%D0%AO%D0%B0%D0%B1%D0%BE%D1%82%D0%B5%D0%BD%20%D0%B4%D0%BE%D0%BA%D1%83%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%82\).pdf](http://www.sep.gov.mk/data/file/PARIRP/%D0%9F%D0%BB%D0%B0%D0%BD%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%B0%D0%BA%D1%82%D0%B8%D0%B2%D0%BD%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%B8%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%80%D0%B5%D0%B0%D0%BB%D0%B8%D0%B7%D0%B0%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%B8%D1%82%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%B5%20%D1%80%D0%B5%D1%84%D0%BE%D1%80%D0%BC%D1%81%D0%BA%D0%B8%20%D0%BE%D1%80%D0%B8%D0%BE%D1%80%D0%B8%D1%82%D0%B5%D1%82%D0%B8%202015%20(%D0%AO%D0%B0%D0%B1%D0%BE%D1%82%D0%B5%D0%BD%20%D0%B4%D0%BE%D0%BA%D1%83%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%82).pdf) (qasja e fundit më 11.04.2016).

⁸Dokumenti është botuar me gjashtë muaj vonë, edhe pse sektori qytetar insistonte për diskutim dhe përfshirje në gusht – shtator 2015.

Strategjia për reformë të gjyqësorit 2016-2020

Buxheti i Republikës së Maqedonisë për vitin 2016 parashikon program për reforma në gjyqësor të Ministrisë së Drejtësisë me qëllim që të përmirësohet efikasiteti dhe efektiviteti gjyqësor nëpërmjet përfundimit të kapaciteteve gjyqësore dhe të kapaciteteve të ministrive për implementim të strategjisë për reforma në gjyqësor, të ligjeve të përbashkëta dhe të infrastrukturës gjyqësore.⁹ Për këtë qëllim janë parashikuar 1, 25 milionë euro për reforma gjyqësore të cilat janë shpërndarë në kategori për blerje të mobilieve, pajisjeve dhe makinerive, si edhe për punë ndërtimore.

Ministria e Drejtësisë në dhjetor të vitit 2015 ka organizuar takim konsultues me palët e prekura, ku janë ftuar edhe përfaqësues të shoqërisë qytetare. Propozim-strategjia u fokusua tek intervenimet reformuese në disa fusha: Gjyqësori; Sistemi juridiko-ndëshkimor; Qasje të drejta dhe transparenca; Politika dhe koordinimi; Gjyqësori administrativ; Sistemet informuese dhe e-Drejtësia. Një pjesë e mendimeve janë në linjë se Propozim-strategjia është shkruar me një stil të pakuptueshëm gjuhësor dhe krijon habi; parashikohen zgjidhje të cilat në thelbin e vet kanë nevojë për ndryshime kushtetuese si edhe për ndryshime të rrënjësishme të ligjeve të cilat miratohen me shumicë prej dy të tretave të votave në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Propozimi i Strategjisë për Reforma të Sistemit Gjyqësor 2016-2020 edhe pse në fazë finale, nuk ishte miratuar deri te tremujori i parë i vitit 2016. Operacionalizimi i masave në lidhje me pavarësinë e gjyqtarëve parashikohet në vitin 2018, dhe kjo kryesisht me ndërhyrje rregullatore dhe ndërhyrje në drejtim të përfundimit të kapaciteteve. Së këtejmi, Strategjia e propozuar në këtë aspekt kyç në të vërtetë drejtpërdrejt u kundërvihet Prioriteteve të Reformave Urgjente. Ky është një shembull evident edhe sa i përket asaj se efekti i ndihmës para-aderuese të KE është në kundërshtim me Prioritetet e Reformave Urgjente të KE, të cilat në këtë mënyrë e minimizojnë. Instituti për të Drejtat e Njeriut, anëtar i Rrjetit 23, e shpalli mendimin në lidhje me drift-versionin e Strategjisë.¹⁰

Strategjia merret në një moment politik tërësisht sensitiv për shtetin pa diskutim të gjerë dhe profesional për risitë/modalitetet që propozohen për zgjidhje të çështjeve kryesore në këtë fushë. Është e domosdoshme nëpërmjet diskutimit gjithëpërfshirës të përcaktohen zgjidhjet të cilat korrespondojnë me mangësitë sistematike të përcaktuara në Raportin e grupit të lartë ekspert për çështje sistematike në mbizotërimin e të drejtës dhe në Prioritetet Urgjente Reformuese.

⁹ Propozim-strategjia është përpunuar me mbështetje profesionale dhe logjistike të projektit për përgatitje të Programit për mbështetje të sektorit gjyqësor dhe projektit IPA 2010 "Mbështetje e mëtejshme për gjyqësi të pavarur, përgjegjëse, profesionale dhe efektive dhe promovim i dënimit me kusht dhe masave alternative".

¹⁰ Instituti për të Drejtat e Njeriut. Sugjerime për Propozim-strategjinë për reforma sektorin gjyqësor 2016-2020. Gjetendet në: http://www.ihr.org.mk/images/izvestai/novosti/sugestii%20na%20strategjijata%20_ichp_finalni.pdf

Pavarësia

Nuk zbatohen prioritetet që lidhen me depolitizimin e emërimit dhe përparimit të gjykatësve, vlerësimin, procedurat disiplinore dhe shkarkimin. Këshilli Gjyqësor, në bazë të Planit Aksionar, vazhdoi të zgjedhë kryetarë të gjykatave dhe gjykatës, pa kurrfarë ndryshimesh paraprake në sistemin e zgjedhjes.¹¹ Disa gjykatës ishin zgjedhur më 23 mars dhe më 4 prill, një ditë para zgjedhjeve të parakohshme të parashikuara, përkatësisht para lëshimit të planifikuar dhe të shtyrë të Kuvendit. Buxheti gjyqësor për vitin 2016 është 1.892.431,00 denarë, që dëshmon se buxheti është zmadhuar në mënyrë jo të theksuar për dallim nga vitet e mëparshme edhe përkrah kritikave se kjo shumë nuk është e mjaftueshme që të mundësojë pavarësi të pushtetit gjyqësor dhe është nën nivelin minimal të përcaktuar me ligj.

Në mbledhjen e mbajtur në nëntor të vitit 2015, Këshilli Gjyqësor miratoi sistematizim të ri të vendeve gjyqësore me të cilat zvogëlohet numri i gjykatësve nga 740 të deritanishëm në 636 gjykatës.

Roli i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në sigurimin e pavarësisë dhe paanësisë është vendosur në pikëpyetje. Në publikimin “Përmirësimi i sistemit të pengesave dhe kontrolleve në Republikën e Maqedonisë: Kontrolli gjyqësor i pushtetit ekzekutiv”, tregohet për besimin e ulët në punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë. Mandej konstatohet se “...¹² [P]othuajse është për t'u habitur që Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë, institucionet të cilat duhet ta garantojnë pavarësinë e gjyqësorit nga ndikimet politike, i kanë marrë vlerësimet më të ulëta... [këta trupa] duhej ta përforconin pavarësinë dhe përgjegjësinë në gjyqësor.¹³ Në praktikë, duket sikur këshillat kanë rol tjetër.” Gjithashtu mund të problematizohet sistemi i zgjedhjes së anëtarëve në këshilla, sidomos cilësia e kandidatëve të propozuar. Vlerësohet se jo vetëm që nuk janë ndërmarrë veprime zmadhimin e cilësisë, në përputhje me PRU, por cilësia është më e keqe me kalimin e kohës. Me këtë jepet “hierarkia funksionale në gjyqësor” që dëshmon bindjen se pjesa më e madhe e kryetarëve të gjykatave (si edhe të prokurorisë) janë nën kontroll të pushtetit ekzekutiv, përkatësisht të partisë në pushtet.

Edhe pse është vënë re prani e zmadhuar publike e kryetarit të Këshillit Gjyqësor, veprimet në atë drejtim kontribuojnë në zmadhimin e rolit proaktiv të këshillit dhe mbrojtjes së gjykatësve në raport me pavarësinë e tyre. Gjatë tryezës së rumbullakët të organizuar nga Këshilli në

¹¹ Këshilli Gjyqësor i RM-së në seancat e mbajtura më 23 dhe më 30 shtator ka marrë vendim për shpalljen e zgjedhjes së 22 gjykatësve në gjykatat më të larta dhe 20 në gjykatat themelore. Për reagimin e “Rrjetit 23” lexo http://epi.org.mk/newsDetail_mk.php?newsid=84. Këshilli më 26 nëntor ka marrë vendime për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës së Apelit Shkup dhe kryetarëve të gjykatave themelore në Berovë dhe Radovish, si dhe vendimeve për përzgjedhje të 11 gjykatësve gjithsej në gjykatat htmelore dhe të apelit. Në seancën e mbajtur më 9 dhjetor 2015 janë marrë vendimi për përzgjedhje të kryetarit të Gjykatës Themelore Strumicë dhe shpallje për përzgjedhje të dy gjykatësve në Gjykatën e Lartë Administrative. Në seancën e mbajtur më 23 shkurt 2016 është marrë vendimi për përzgjedhje të kryetarëve të Gjykatës së Apelit Manastir, gjykatave themelore në Ohër dhe Koçan, si dhe vendimi për publikimin e shpalljeve për zgjedhjen e gjykatësve në Gjykatën e Lartë. Gjykatën e Apelit Shtip dhe katër gjykatave themelore.

¹² Dr. Dane Talevski, dr. Marko Kmeziq, mr. Lura Pollozhani “Përmirësimi i sistemit të pengesave dhe kontrolleve në Republikën e Maqedonisë: Kontrolli gjyqësor i pushtetit ekzekutiv”, Instituti për Politikë Evropiane (PE)- Shkup, mars 2016, gjendet në: http://epi.org.mk/docs/D4V_Democracy%20and%20Rule%20of%20Law_mk.pdf (f. 25, 27).

¹³ Dr. Dane Talevski, dr. Marko Kmeziq, mr. Lura Pollozhani “Përmirësimi i sistemit të pengesave dhe kontrolleve në Republikën e Maqedonisë: Kontrolli gjyqësor i pushtetit ekzekutiv”, Instituti për Politikë Evropiane (PE)- Shkup, mars 2016, gjendet në: http://epi.org.mk/docs/D4V_Democracy%20and%20Rule%20of%20Law_mk.pdf (mbi metodologjinë shiko f. 24 paragrafi 2).

nëntor të vitit 2015, kryetari i Këshillit Gjyqësor deklaroi se Raporti i Komisionit Evropian në pjesën e gjyqësorit përmban standarde të dyfishta¹⁴ dhe me këtë e mohon konstatimin se në shtet është konstatuar kthim pas në pjesën e gjyqësorit. Nuk është vënë re “realizim i rolit proaktiv të Këshillit Gjyqësor dhe zmadhim të profesionalizmit të tij”, kurse sidomos nuk janë të dukshme veprimet të cilat duhet të shënojnë parashikim të mjaftueshëm në përkufizimin “jurist i njohur” (nuk mjafton vetëm stazhi prej 15 vjetësh) si kusht për anëtarësim në Këshillin Gjyqësor. Kjo është bazë sipas së cilës është bërë zgjedhja e kryetarit të tanishëm të Këshillit Gjyqësor dhe kjo në mungesë të opozitës.

Në një nga fjalimet e veta¹⁵ në mars të vitit 2016, kryetari i Këshillit Gjyqësor, i cili nuk ka qenë asnjëherë gjykatës, nënvizoi se “... disa ekspertë eminentë, një pjesë e tyre me qëllim të mirë, një pjesë e tyre pa dashur.. atë që e kritikojnë tashmë është implementuar” dhe se kritikata të cilat u drejtohen kanë “konotacion politik ditor dhe në parim i dëmtojnë aktivitetet e ndërmarra nga institucionet gjyqësore”. Kjo retorikë është në drejtim të reagimit të shpallur me rastin e Raportit të KE-së në të cilin është përcaktuar kthim pas në fushën e gjyqësorit..

Me punë filloi Komisioni për Barazim të Politikës ndëshkimore, i themeluar në përputhje me Ligjin për Përcaktim të Llojit dhe Matjes së Madhësisë së Gjobës,¹⁶ që ka hyrë në fuqi në janar të viti 2015. Për president, nga Kuvendi i RM-së, është zgjedhur Jovan Ilievski, i cili udhëheq Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekje të Krimit të Organizuar. Partitë e opozitës reagojnë ndaj kësaj zgjedhjeje, duke pasur parasysh se z. Ilievski ka lidhje të afërta familjare me Sasho Mijallkov, ish drejtorin e Drejtorisë për Sigurim dhe Kundërzbulim, i inkriminuar në bisedat telefonike të përgjuara jolegalisht të shpallura në vitin 2015.

Janë vendosur shtesa të reja në rrogën e gjykatësve dhe të prokurorëve publikë pas miratimit me procedurë të shkurtuar të propozim-ligjeve të dorëzuara nga Qeveria më 30 dhjetor 2015, qëllimi i të cilës është mbështetja parazgjedhore dhe investimi në servilizmin e tyre ndaj urdhrave politike. Në të njëjtën seancë është miratuar edhe propozimi për zmadhimin e rrogave në shërbimin e prokurorisë publike, paralelisht me miratimin e propozim ligjit për të punësuarit në shërbimin e prokurorisë publike të PPS-së. Me këtë hap Qeveria u përpoq ta “neutralizojë” pakënaqësinë e shërbimit të prokurorisë publike prej vendosjes së shërbimit të prokurorisë publike në PPS.

¹⁴Për Këshillin Gjyqësor, KE-ja ka standarde të dyfishta. Telma 27.11.2015. gjendet në:

<http://telma.com.mk/vesti/za-sudskiot-sovet-ek-ima-dvojni-standardi-za-sudstvoto>

¹⁵Shpallje – Shënimi i Ditës së Gjyqësorit 31 mars 2016. Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë. Gjendet në: [http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=412\[qasja_e_fundit_më:11.04.2016\]](http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=412[qasja_e_fundit_më:11.04.2016]).

¹⁶Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 199/2015.

Prokuroria Publike Speciale

Indikacionet serioze për lidhje dhe përzjerje të pushtetit ekzekutiv me prokurorinë publike e nxorën nevojën për formimin e prokurorisë publike speciale për ndjekje të veprave penale që lidhen dhe dalin nga përmbajtja e ndjekjes joligjore të komunikimeve. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në përputhje me Marrëveshjen e Përzghinos, më 15 shtator 2015, njëzëshëm e miratoi Ligjin për Prokurorinë Publike për Ndjekje të Veprave Penale të cilat lidhen dhe dalin nga përmbajtja e ndjekjes joligjore të komunikimeve. Me këtë ligj edhe zyrtarisht është parashikuar edhe ekzistenca e prokurorit special publik, i cili është i obliguar për hetim dhe ndjekje të veprave penale të cilat lidhen dhe dalin nga përmbajtja e ndjekjes së paautorizuar të komunikimeve dhe ekzistimi i prokurorisë të cilën e udhëheq prokurori publik, që përfshin edhe prokurorë publikë të zgjedhur në këtë prokurori, hetues, ekspertë, shërbim ekspert dhe administrativ.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë për këtë funksion e propozoi Katica Janeva, prokurore publike nga Gjevgjelia. Propozimi është miratuar njëzëshëm nga Këshilli i Prokurorëve Publikë dhe prokurorja publike speciale hyri në detyrë më 16 shtator, pas dhënies së betimit zyrtar.

Edhe përkrah faktit se prokurorja publike speciale është zgjedhur me procedurë urgjente, megjithatë prokuroria filloi me punë në muajin dhjetor të vitit 2015, për shkak të obstrukcioneve nga Këshilli për Prokurorë Publikë në raport me ekipin e kërkuar nga prokurorja. Frenimi i punës së prokurorisë publike ka vijuar pas frenimit të negociatave për përbushje të Marrëveshjes së Përzghinos, që jep një dyshim me bazë për ndikimin politik edhe mbi vendimet e Këshillit të Prokurorëve Publikë. Mandej është tejkaluar afati ligjor prej 35 ditësh për siguri të mjeteve financiare për punën e prokurorisë speciale publike, që edhe më tepër e ngadalësoi punën e saj. Megjithatë, edhe përkrah afatit të shkurtër kohor dhe obstrukcioneve nga institucionet e tjera, PSP-ja arriti të formohet si një organ i pavarur në sistemin e prokurorisë publike në RM.

Informacionet e para për hetimet e filluara janë dhënë në opinion më 12 shkurt 2016. PSP-ja nëpërmjet konferencave për shtyp e ka informuar opinionin se është hapur procedurë hetimore ndaj më tepër personave për vepra penale kundër zgjedhjeve dhe votimit,¹⁷ rastin të cili PSP-ja e emërtoi si "Titanik".¹⁸

PSP-ja informoi se është hapur hetim edhe kundër anëtarëve të komisionit zgjedhor komunal në Çair, sepse ekziston dyshim i bazuar se kanë kryer vepër penale Mashttrim zgjedhor, si dhe hetim për pesë gjykatës të Gjykatës Administrative në Shkup dhe për katër anëtarë të Komisionit Shtetëror Zgjedhor të vitit 2013 për veprën penale – Keqpërdorim i pozitës dhe autorizimeve zyrtare të nenit 353 të KZ-së. Më 13.02.2016 PSP-ja ka dhëni dy propozime për përcaktim të masës paraburgim ndaj personave të dyshuar të cilat janë refuzuar nga

¹⁷Transkriptimi i tërësishtëm konferencës për shtyp i mbajtur mund ta lexoni në faqen zyrtare të Fejbukut të Prokurorisë Speciale Publike në këtë link: https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=678493328920887&id=650104671759753

¹⁸Të dyshuarit, të cilët gjatë vitit 2012 kanë qenë ministër për punë të brendshme, ministër për transport dhe lidhje dhe sekretar i Qeverisë së R. Maqedonisë, së bashku me të gjithë anëtarët e komitetit ekzekutiv të partisë dhe të tjerë, për tani persona të panjohur, duke e shfrytëzuar pozitën e vet zyrtare kanë krijuar grup, i cili ka për qëllim kryerje të veprave penale kundër zgjedhjeve dhe votimit.

¹⁹Shpalljet e Gjykatës Themelore Shkup q Shkup në lidhje me kërkesat dhe vendimet për përcaktim të masës paraburgim në rastin "Titanik" mund t'i lexoni në ueb-faqen e gjykatës në këtë link: <http://www.oskopje1.mk/Novosti.aspx>

Në lidhje me vendimin e Gjykatës Themelore Shkup 1, Shkup, Koalicioni “Të gjithë për Gjykim të Drejtë”²⁰, anëtar i Rrjetit 23 konstatoi se seria e mangësive në proces, sidomos se “në përputhje me LPP, këshilli penal nga neni 25 paragrafi 5 i LPP-së në afat prej 48 orësh duhej të merrte vendim për ankesat deri në fund të 16.02.2016, por kjo nuk ishte kryer.” Mandej, thuhet se ky veprim i gjykatës “u ballafaqua me shumë reagime nga avokatë dhe juristë të shquar, duke e emërtuar procedurën e gjykatës si precedente.” Koalicioni flet se kjo procedurë sipas tyre është e pazakonshme dhe e jashtëzakonshme që njëkohësisht flet për veprimin klasik të jashtëligjshëm nga gjykata, duke thënë “Konkretisht është shkelur neni 169 paragrafi 4 i LPP. Domethënë, këshilli penal pas përfundimit të 48 orëve ende nuk ka marrë vendim për shqiptimin e katër ankesave të para, që do të thotë se këshilli penal ka vepruar në kundërshtim me ligjin.”²¹

Që nga fillimi PSP-ja ballafaqohet me vështirësi në bashkëpunimin me institucionet, sidomos me Gjykatën Themelore Shkup 1, Shkup, Agjencinë për Kadastër, Njësinë e Pestë të DSK në MPB, Njësinë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve në MPB; Komunën e Manastirit; Gjykatën Administrative; Prokurorinë Publike Themelore Shkup dhe Prokurorinë për Ndjekjen e Krimit dhe Korrupsionit të organizuar. Mosbashkëpunimi i tillë me PSP-në ndikon në shtyrjen e procedurave të caktuara parahetimore, kurse mund të çojë edhe në pengimin e hetimit dhe të bëjë të pamundur të ngrihen procedura gjyqësore kundër personave për të cilët ka dyshim të me bazë se kanë kryer vepra të rënda penale të cilat e rrezikojnë edhe rendin kushtetues.

Në raportin mbi punën e vet për gjashtë muajt e parë,²² PSP-ja informoi se është vendosur kompetencë reale në 30 lëndë kundër 80 personave.

Edhe përkrah faktit se PSP-ja filloi luftë serioze kundër korrupsionit në vend në nivelin më të lartë, Presidenti i RM-së, Gjorgje Ivanov, vendosi që në mënyrë kolektive të amnistojë 57 persona të dyshuar, nga qeveria dhe opozita, për të cilët janë ngritur fletëparaqitje penale dhe janë ngritur procedura penale. Me këto veprime Presidenti i Republikës së Maqedonisë, Gjorgje Ivanov, e ka tejkaluar autorizimet e veta kushtetuese dhe ligjore dhe kështu ka kryer veprë penale keqpërdorim i pozitës zyrtare nga neni 353 të Kodit Penal të RM-së.

Domethënë, qëndrimi dhe vendimet për amnisti Presidenti i ka marrë pa bazë ligjore duke pasur parasysh faktin se neni 11 i Ligjit për Amnisti, të cilit i referohet ai, është shfuqizuar dhe nuk është pjesë e rendit juridik në Republikën e Maqedonisë. Kështu Presidenti është vënë mbi të drejtën, mbi Kuvendin dhe mbi Marrëveshjen Politike të Përzahinos, duke shfuqizuar kështu një pjesë të madhe të autorizimeve të Prokurorisë Speciale Publike, si organ i pranuar në mënyrë konsenzuale kompetent për ndjekjen e veprave penale të cilat lidhen me bisedat e përgjuara në mënyrë të jashtëligjshme. Akti i tillë nuk është vetëm një akt i rrëzimit të shtetit juridik, por shkelje e serioze e obligimeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë.

²⁰Mr. Aleksandra Bogdanovska dhe Natali Petrovska “Këshilli Penal versus Ligjit për Procedurë Penale”, Koalicioni “Të gjithë për Gjykim të Drejtë”. 18 shkurt 2016. Gjetet në:

²¹Ibid. (f. 5)

²²Raportin e tërësishtëm mund ta lexoni në linkun e mëposhtëm:

<http://www.jonsk.mk/%D0%B4%D0%BE%D0%BA%D1%83%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%82%D0%B8/>

Shteti ka obligim pozitiv të sigurojë përdorim të pandërprerë dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut të parapara në Konventën Evropiane dhe në marrëveshjet e tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe obligimet e qarta procedurale për hetim themelor dhe efektiv të shkeljeve të të drejtave të njeriut, dënimit të kryerësve të tyre dhe parandalim të rasteve të tilla në të ardhmen. Me amnistinë e disa prej veprave penale të përfshira në vendimet e Presidentit, në këtë kuptim praktikisht janë shkelur edhe obligimet e neneve 2 dhe 3 të Konventës Evropiane të cilat garantojnë të drejtën e jetës dhe ndalojnë keqtrajtimin, trajtimin johuman dhe degradues, si dhe shkeljen masive të të drejtave të njeriut të privatësisë nga neni 8 i Konventës Evropiane duke pasur parasysh se për këtë nen shteti duhet të sigurojë kontroll efikas mbi keqpërdorimet e mundshme të përgjimeve joligjore. Njëkohësisht, duke i penguar procedurat penale Presidenti i ka shkelur të drejtat e viktimave të këtyre keqpërdorimeve duke i privuar viktimat nga mjeti juridik efektiv, i cili do të siguronte kënaqësi penale, morale dhe materiale për viktimat. Me këtë është kryer shkelje e nenit 6 të GjEDNj-së në kuptimin e pamundësisit të qasjes efikase të gjykata, si dhe shkelje të nenit 13 të GjEDNj-së për shkak të pamundësisit të mjetit juridik efikas për mbrojtje të lirive dhe të drejtave të shkelura. Me veprimet e dhëna, Presidenti dhe N.N. personi apo personat të cilët ia kanë dorëzuar të dhënat për procedurat e hapura penale kanë kryer vepër penale të shkeljes së sekretit të procedurës nga neni 369 të Kodit Penal, kurse në lidhje me nenet 289 dhe 299 të Ligjit për Procedurë Penale që parashikojnë sekretet të procedurës penale.

Nuk duhet të shpërfillet fakti se me pengimin e drejtësisë penale të një numër i madh veprash korruptuese të përfshira me faljet, Presidenti i ka shkelur obligimet ndërkombëtare të shteteve për ndalimin dhe ndjekjen e korrupsionit, pastrimit të parave duke i shkelur dispozitat e Konventës së Palermos. Presidenti, gjatë përdorimit të autorizimeve të tij nuk e ka dhënë arsyetimin e domosdoshëm për çdo rast të veçantë të amnistuar por ofron arsyetime politike, prej të cilave nuk shihet arsyetimi i tyre dhe interesi i shtetit.

Pavarësia e gjyqësorit po shkelet vazhdimisht. Nuk janë realizuar Prioritetet Reformuese Urgjente të cilat lidhen me pavarësinë e gjyqësorit. Duhet të rikontrollohet tërësisht modeli i zgjedhjes dhe anëtarësisit në Këshillin Gjyqësor. Zgjedhja dhe emërimi i gjykatësve dhe kryetarëve pa u përmbushur kushtet e parashikuara me Prioritetet Reformuese Urgjente e zmadhon perceptimin për zmadhim të politizimit, si dhe zmadhon mosbesimin e mëtejshëm në këtë institucion si tek gjykatësit ashtu edhe te opinioni publik. Zgjedhja duhet të jetë transparente dhe lëndë e mbikëqyrjes publike me qëllim që të ruhen parimet e profesionalizmit dhe përgjegjësisë. Këshilli Gjyqësor i RM-së duhet të hapet për opinionin publik dhe t'i shpallë publikisht të gjitha vendimet strategjike dhe aktet e brendshme lidhur me pavarësinë dhe paanësinë e gjyqësorit.

Presidenti i RM-së e keqpërdori pozitën dhe autorizimin e vet zyrtar, nëpërmjet ndalimit të paligjshëm të ndjekjes së personave të dyshuar për shkelje masovike të të drejtave të njeriut dhe për korrupsion, që është në kompetencë të Prokurorisë Publike Speciale. Me këtë procedurë presidenti i ka shkelur parimet e mbizotërimit të së drejtës dhe ndarjes së pushtetit, për çka duhet të mbajë përgjegjësi.

Është e domosdoshme të ndalen të gjitha obstrukcionet në punën e Prokurorisë Publike Speciale, kurse institucionet të bashkëpunojnë dhe të sigurojnë dokumentet me kërkesë të PPS-së, në përputhje me dispozitat e LPP-së. Duhet të formohet njësi gjyqësore e specializuar në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup, që do të ketë kompetencë të veprave vetëm për lëndët për veprat penale të cilat lidhen dhe dalin nga ndjekja joligjore e komunikimeve. Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë duhet të shpallë konkurs për gjykatës të cilët do të punojnë në këtë njësi. Gjykatësit do të zgjidhen nga Këshilli Gjyqësor, me një debat të gjerë dhe duke marrë mendimin nga palët e prekura, sidomos organizata të njohura qytetare aktive në fushën e jurisprudencës.

Të bëhen ndryshime ligjore të nenit 22 i Ligjit të Prokurorisë publike për hetim të veprave penale të lidhura dhe të cilat dalin nga përmbajtja e ndjekjes joligjore të komunikimeve në mënyrë që afati i ngritjes së padisë nga ana e Prokurorisë publike speciale prej 18 muaj do të jetë i vazhduar në 24 muaj.

Duhet të sillen ndryshime plotësuese të ligjit me qëllim që të precizohet se afati i fundit prej 24 muaj nuk sillet në rastet e reja të mundshme të cilat dalin prej ose janë të lidhura me përgjimet jolegale (neni i ri 22, qëndrim 1). Për rastet e këtilla, afati për vendosje të padisë duhet të jetë 18 muaj nga momenti kur PSP ka sjellë vendim për fillimin e padisë hetuese (neni i ri 22 qëndrim 2).

■ Paanshmëria dhe përgjegjësia

Në vitin 2014, në kundërshtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Procedurë Penale policia me iniciativën e vet dhe pa urdhër paraprak nga gjykata, arrestoi 14 gjykatës dhe 11 nëpunës profesionale e të tjerë në Njësinë për kundërvajtje në Gjykatën Themelore Shkup 1. Domethënë, këta persona janë privuar nga liria në vendet e tyre të punës, pa miratim nga gjykata, ku policia nuk mund të privojë nga liria vetëm në rastet e urgjencës së jashtëzakonshme, ndërsa jo për vepra të cilat janë ndjekur dhe hetuar një rrugë të gjatë. Mënyra e arrestimit ishte shokuese dhe e mbuluar me qëllim nga mediat, me çka u përsëritën praktikata e mëparshme të MPB-së për arrestim publik të të dyshuarve me eksponim në media, që ndikon në prezumimi i pafajësisë së të dyshuarve.

Me veprimin e tillë duket tendenca e pushtetit ekzekutiv që të ndikojë mbi gjyqësorin, me çka shkelet parimi i mbizotërimit të së drejtës.²³ Gjatë muajit maj Prokuroria Publike Themelore Shkup shpalli se ka bërë marrëveshje me 8 gjykatës të dyshuar.²⁴ Të gjithëve u janë shqiptuar aktvendime me kusht. Në dhjetor të 2015, me vendim të Gjykatës Supreme i a.q. lënda “Justicia”, kompetenca vendore e Gjykatës Themelore Shkup 1 është përcjellë te Gjykata themelore Manastir, me qëllim që gjykatësve të mos u gjykojë gjykata ku kanë qenë të punësuar. .

Në tetor të viti 2015, me dyshimin se ka kryer keqpërdorim të pozitës dhe autorizimeve zyrtare dhe shoqërimit kriminal, është arrestuar kryetari i Gjykatës Themelore Kumanovë. Arrestimi ishte i ngjashëm si dhe te lënda e a.q. “Justicia”, përkatësisht me prani më të madhe të policisë dhe mediave gjatë arrestimit të kryetarit në ndërtesën e gjykatës. Vendimet për përcaktim dhe vazhdim të masës paraburgim nuk ishin në përputhje me Ligjin për Procedurë Penale, përkatësisht nuk ishin arsyetuar. Për një prej vendimeve që janë ankimuar Këshilli Penal i Gjykatës Themelore Shkup 1 nuk është marrë vendim në afat prej 48 orësh.²⁵ Kryetari i gjykatës, me vendim të Gjykatës së lartë është liruar nga paraburgimi në mars të vitit 2016, pas pesë muajsh e gjysmë në paraburgim.

Gjykata Supreme e RM-së në tetor të vitit 2015 ka shënuar 70 vjetorin e ekzistencës së vet.²⁶ Në fjalën e vet përshëndetëse, kryetarja, Lidija Nedellkova kërkoi “mbështetje nga mendimi publik për ndalimin e fushatës kundër gjyqësorit të Maqedonisë që prezantohet me një pamje të shtrembëruar para opinionit, ka dobësi dhe lëshimet, por megjithatë të mos harrojmë se është shtyllë e konstruksionit të shtetit”.²⁷

Ajo bëri thirrje “të mos bëhen kritika, shpifje afrofe, të mos e shkatërrojmë sistemin gjyqësor, ky është apel që atë ta përforcojmë me ide, me mendim të mirë, ta aftësojmë për funksionim efikas, për gjykim të drejtë dhe efikas të bazuar në ligj.”²⁸

Është për t'u përshëndetur fakti që pas shumë vitesh, Gjykata Supreme pas një kohe të gjatë shpalli përmbledhjen e botuar “Përmbledhje vendimesh 2004-2014”.²⁹

Komiteti i Helsinki te Gjykata Supreme ka dorëzuar kërkesë për qasje tek informacionet me karakter publik në lidhje me numrin e qëndrimeve parimore dhe mendimeve juridike të miratuara, numrin e mendimeve të dorëzuara për propozim të ligjeve dhe dispozitave të tjera kur me to rregullohen çështje me rëndësi për punën e gjykatave (për periudhën 2010 deri në vitin 2015). dhe numrin e kërkesave të dorëzuara për gjykim në afat të arsyeshëm dhe

²³ Komiteti i Helsinki: Paralamjërmi i zëshëm për vendosjen e shtetit policor! <http://mhc.org.mk/announcements/249>

²⁴ <http://jorm.gov.mk/?p=1806>

²⁵ Ymbikëqyrje në Lëndën KOK. PP nr. 547/15-12 nga Komiteti i Helsinki.

²⁶ Për shkak të mungesës së mjeteve në buxhetin personal, madje edhe eventimenti është mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Shkup, me kërkesë të Gjykatës Supreme

²⁷ Fjalimi i Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, Lidija Nedellkova, që e mbajti në Akademinë soleme me rastin e 70 vjetorit të Gjykatës Supreme, mbajtur më 2.11.2015, gjendet në HYPERLINK"http://www.vsrn.mk/cms/FCKEditor_Upload/File/%D0%93%D0%BE%D0%B2%D0%BE%D1%8070%20%D0%B3%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D0%BD%D0%B8.pdf qasje më 20.05.2016.

²⁸ Ibid.

²⁹ http://vsrn.mk/cms/FCKEditor_Upload/File/%D0%97%D0%B1%D0%B8%D1%80%D0%BA%D0%B0%20%D0%BD%D0%B0%20%D1%81%D1%83%D0%B4%D1%81%81%D0%BA%D0%B8%20%D0%BE%D0%B4%D0%BB%D1%83%D0%BA%D0%B8%202004-2014.pdf.

zhdëmtimi i paguar në vitin 2015. Sipas përgjigjes së marrë nga Gjykata Supreme, në vitin 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2015 nuk ka miratuar qëndrime parimore dhe mendime juridike. Në vitin 2012 është miratuar një (1) qëndrim parimor dhe mendim juridik, kurse në vitin 2014 janë miratuar tre (3) mendime juridike parimore. Në lidhje me numrin e mendimeve të dorëzuara për propozim të ligjeve, sipas Gjykatës Supreme, nga propozuesi – Ministria e Drejtësisë, për periudhën e kërkuar nuk është kërkuar mendim nga Seancat e Përgjithshme për propozim-ligje, përveç aktit nënligjor Rregullorja e punës për gjykatat dhe për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për gjykatat. Sipas, këtyre të dhënave mund të nxirret përfundime se Gjykata Supreme i kushton minimum kohë për një prej kompetencave themelore të veta dhe nuk kontribuon në përparimin e cilësisë së gjyqësorit dhe praktikës gjyqësore.

Në lidhje me numrin e kërkesave të dorëzuara për gjykim në afat të arsyeshëm dhe zhdëmtim të paguar në vitin 2015, Gjykata Supreme ka marrë 451 kërkesa dhe 172 ankesa. Janë zgjedhur 421 kërkesa dhe 174 ankesa (numri i ankesave është më i madh se ai i pranuar për shkak të ankesave të pazgjidhura nga viti 2014). Janë miratuar 238 kërkesa gjithsej. Prej 588 lëndëve të zgjidhura, është gjykuar kompensim i drejtë në shumë të përgjithshme prej 6.344.100,00 (rreth 103.000 euro), si në emër të kompensimit të drejtë, ashtu edhe për shpenzime në procedurën me ngritjen e rastit të kërkesës së dorëzuar për mbrojtje të të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm. Sipas informacioneve të marra, mund të nxirret përfundimi se Gjykata Supreme punon në mënyrë azhurne për lëndët për gjykim në afat të arsyetueshëm.

Në bazën e re qendrore të paralajmëruar të të dhënave të Gjykatës Supreme në RM, nëpërmjet të cilës duhet të shpallen aktvendimet e të gjitha gjykatave në shtet, është panjohur a do të jenë edhe aktvendimet gjyqësore të shpallura në ueb-faqet e veçanta të gjykatave, me çka vendoset në pikëpyetje kuptimi i intervenimit të tillë. Nëse në këtë databazë nuk vendosen edhe aktvendimet gjyqësore të mëparshme, jo vetëm që ky intervenim nuk është në dobi të prioritetit për shpallje në kohë të të gjitha vendimeve gjyqësore por edhe është në kundërshtim me këtë prioritet, i cili para së gjithash lidhet me shpalljen e aktvendimit nga gjykatësi në afatin e caktuar ligjor.

Edhe përkrah reagimeve të sektorit qytetar,³⁰ duke dëshmuar se Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktim të Përgjegjësisë së Gjykatësit (mandej: Këshilli për Përcaktim të Fakteve) nuk është zgjidhja përkatëse për zbatim të rekomandimeve të GREKO, janë ndërmarrë veprime për zgjedhje të anëtarëve dhe konstituimit të tij. Ky Këshill është paraparë si një trup i ri gjyqësor, i cili do të ketë qëllim të ndërmarrë një pjesë të punës së Këshillit Gjyqësor të RM-së. Kompetenca e tij ka të bëjë me ngritjen e procedurës disiplinore dhe procedurës për punë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të gjykatësve para Këshillit Gjyqësor të RM-së. Këshilli për Përcaktimin e Fakteve do të mund t'i hedhë poshtë iniciativat për përcaktim të përgjegjësisë, pas kësaj vendimi i tij bëhet përfundimtar, përkatësisht iniciativat e refuzuara nuk do të merren në shqyrtim nga Këshilli Gjyqësor në RM. Këshilli zbatoi zgjedhje për anëtarët dhe rezultatet e zgjedhjes janë simptomatike për shkak të numrit të ulët të votave të marra për kandidatët. Rezultatet gjenden në ueb-faqen e Këshillit

³⁰ Rrjeti 23, Ndjekje e Prioritetëve Reformuese urgjente, gjendet në: http://epi.org.mk/newsDetail_mk.php?nwsid=89

Gjyqësor: <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=332>. Përveç këtyre aktiviteteve nuk filloi me punë Këshilli për Përcaktimin e Fakteve. Komisioni i Venecias në dhjetor të vitit 2015 e ka shprehur mendimin e vet për risitë e propozuara në ligjet për gjykatat, Këshilli Gjyqësor i RM-së dhe Këshilli për Përcaktim të Fakteve në lidhje me përgjegjësinë disiplinore dhe vlerësimin e gjykatësve.³¹ Komisioni thekson se reformat e tilla të rëndësishme në kushte normale duhet të marrin mbështetjen më të gjerë politike, në të kundërt ekziston rreziku se opinioni do t'i shikojë (me të drejtë ose jo) si përpjekje e shumicës që të formojë organe të reja të krijuara, kurse nëpërmjet tyre, të vendoset kontroll mbi gjyqësorin. Mendimi i dhënë nuk është dobi të formimit të trupit të veçantë për përgjegjësi disiplinore dhe propozohet funksionet e Këshillit për Përcaktim të Fakteve të kthehen në Këshillin Gjyqësor, duke pasur parasysh se anëtarët e Këshillit Gjyqësor të cilët do të involvohen në fazën e parë të inicimit të procedurës disiplinore nuk do të marrin pjesë në marrjen e vendimit për përgjegjësi disiplinore

Kuvendi i RM-së më 30 dhjetor e miratoi Propozim-ligjin për të punësuarit në shërbimin e prokurorisë publike të Prokurorisë Publike për ndjekje të veprave penale të cilat lidhen ose dalin nga përmbajtja e ndjekjes joligjore të komunikimeve, të dorëzuar nga Qeveria me procedurë të shkurtër.³² Propozimi së pari është dorëzuar më 21 dhjetor nga një grup deputetësh të LSDM-së, PRSD-së, PLD-së dhe PDT-së, por nuk arriti në rend të ditës sepse deputetët e VMRO-DPMNE-së kanë votuar kundër, me arsyetimin se ai material tashmë është rregulluar me ligje të tjera për prokurorinë publike, shërbimin dhe administratën e prokurorisë publike dhe me ligjin e propozuar kjo prokurori do të ishte me pozitë të privilegjuar. Qeveria ka dorëzuar Propozim-ligj për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Rrogat e Prokurorëve Publikë dhe Ligjit për Rrogat e Gjykatësve me procedurë të shkurtër.³⁴

Me zgjidhjet ligjore të propozuara parashikohen baza shtesë për shtesa në rrogat. Madhësia dhe mënyra e përcaktimit të shtesave përcaktohen me akt të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, përkatësisht Prokurori Publik i RM-së, me miratim paraprak nga ministri i financave. Në reagimin e vet prokurorja speciale publike Janeva vlerësoi se dispozita e cila e autorizon Prokurorin publik të RM-së, me miratim paraprak nga ministri i financave, që të vendosë për shtesat e prokurorëve publikë në këtë prokurori publike, thyhen parimet e vendosura të autonomisë dhe pavarësisë financiare. Mandej, Qeveria ka dorëzuar një propozim-ligj të plotësuar, që parashikon se shtesat, madhësia e tyre dhe mënyra e përcaktimit për prokurorinë speciale publike përcaktohen me akt të prokurorit publik i cili udhëheq me të. Në mënyrë analoge, kompetenca e tillë parashikohet edhe për prokurorin publik i cili udhëheq me Prokurorinë Publike Themelore për ndjekje të krimit dhe korrupsionit të organizuar.

³¹[http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2015\)042-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2015)042-e)

³² Materialet i seancës gjendet në: <http://www.sobranie.mk/sessiondetails.nspx?sessionDetailsId=514ae52a-f803-4ef7-9096-92fb31766def&date=30.12.2015>

³³ Kuvendi miratoi më tepër ndryshime dhe plotësime të ligjit nga fusha të ndryshme MIA. 21.12.2015. Gjendet në: <http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/381/132953583>.

³⁴ Materialet e tërësishtme gjenden në: <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nspx?materialId=d22bc200-1622-4dd7-9428-a6893925c922> dhe <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nspx?materialId=e274859b-52a8-4434-b9ba-3f28685dca8f>.

Privimi nga liria e gjykatësve nuk duhet të zhvillohet në mënyrën siç ishte rasti në vitin 2014 dhe 2015, përkatësisht Këshilli Gjyqësor duhet të dalë në mbrojtje të arrestimeve spektakulare nga policia në ndërtesat e gjykatave, kurse Prokuroria Publike të reagojë ndaj shkeljeve të parimit të prezumimit të përfaqësuesve të gjyqësorit.

Ligji për Këshillin për përcaktim të fakteve dhe ngritjen e procedurës për përcaktim të përgjegjesisë së gjykatësit duhet të shfuqizohet, duke e kthyer njëkohësisht këtë kompetencë te Këshilli Gjyqësor, kështu që do të sigurohen parimet e paanësisë dhe objektivitetit.

Mosfeksionimi i bazës qendrore të paralajmëruar prej kohësh të aktvendimeve gjyqësore nuk kontribuon në transparencë të gjyqësorit dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore në shtet. Gjykata Supreme duhet të përshpejtojë procedurën e ngritjes së bazës dhe të gjejë mënyrë aktvendimet e marra dhe të shpallura në gjykatat themelore dhe të apelit të vendosen në bazën qendrore. Përshëndetet aktiviteti më i madh i Gjykatës Supreme për organizim dhe pranishmëri në evenimente dhe takime profesionale me palët e prekura dhe pritët zhvillim i dialogut me sektorin qytetar, drejtuar ndaj zmadhimit të besimit të qytetarëve në gjyqësor.

■ Profesionalizmi, specializimi dhe efikasiteti

Nuk janë ndërmarrë kurrfarë hapash që të ndryshojnë kriteret për vlerësim dhe përparim të gjykatësve, të cilat bazohen vetëm në kriteret numerike për efikasitet. Përkundrazi, përfaqësuesit e Këshillit Gjyqësor të RM-së shumë herë i ka theksuar përparësitë e sistemit me të cilin “automatiki” dalin në sipërfaqe gjykatësit me rezultate më të mira.³⁵ Sipas mendimeve të veçanta, sistemi i tanishëm i përparimit të gjykatësve nuk i vendos në plan të parë profesionalizmin dhe integritetin.³⁶

Me intervenimet në sistemin e vlerësimit, përparimit dhe përzgjedhjes së gjykatësve gjatë viteve të kaluara u siguroi “një derë e hapur” për politizim të gjyqësorit.

Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë

Në dhjetor të vitit 2015, Kuvendi i RM-së e ka miratuar Ligjin për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit për Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë.³⁷ Ndryshimet parashikojnë mbrojtje elektronike gjatë zbatimit të tyre, kontroll të ashpër të provimeve të mbajtura dhe sanksioneve kundërvajtëse për shkelje të këtyre dispozitave ligjore. Nëpërmjet ndryshimeve këmbëngulet të zmadhohet transparenca nëpërmjet kërkesës për nxjerrje të thirrjes publike për kandidatët për anëtarë të Këshillit Programor nga radhët e profesorëve dhe juristëve të shquar. Në Buxhetin për vitin 2016, për akademinë janë paraparë rreth 675.000 euro (që është një zmadhim në krahasim me vitin 2014 dhe 2015).

³⁵ Shpallje të Gjykatës Themelore Shkup 1 në lidhje me kërkesat dhe vendimet për përcaktim të masës nëpërmjet: <http://www.osskopje1.mk/Novosti.aspx>

³⁶ Raporte vjetore për punësim në prokuroritë publike në Republikën e Maqedonisë për vitin 2012, 2013 dhe 2014: http://jorm.gov.mk/?page_id=31

³⁷ „Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 231/2015

Në vitin 2015, Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë publikoi shpallje për pranim të 30 dëgjuesve të rinj në një trajnim fillestar të cilët do të ishin kandidatë për gjykatës dhe prokurorë publikë. Në shpallje për fillim të trajnimit në Akademi janë paraqitur 82 kandidatë, kurse 60 prej tyre në mars të vitit 2016 e kanë kaluar testimin kualifikues. Sipas kësaj, këtë vit (për dallim nga ciklet e mëparshme kur nuk kishte kandidatë të mjaftueshëm për të gjitha vendet e shpallura) janë paraqitur nga dy kandidatë për një vend.

Në suazat e hulumtimit të perceptimit të cilin e kanë avokatët për Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, të zbatuar nga Koalicioni “Të Gjithë për Gjykim të Drejtë” në muajin dhjetor 2015, kanë marrë pjesë 45 avokatë.³⁸ Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve: 67% nga të anketuarit e kanë vlerësuar si të pamjaftueshëm kontributin e Akademisë në cilësinë e drejtësisë; 76% nuk e njohin sa duhet punën e Akademisë; 89% të të anketuarve konsiderojnë se avokatët nuk kanë qasje të mjaftueshme te trajnimet e Akademisë sepse shpesh herë nuk janë pranuar që të ndjekin trajnimin; vetëm 38% kanë marrë pjesë në trajnim të organizuar nga Akademia; 62% janë të kënaqur nga cilësia e trajnimeve, por konsiderojnë se duhet të marrin më tepër avokatë si trajnues dhe të përshtaten temat dhe metodologjia me nevojat e avokatëve. Avokatët konsiderojnë se anëtarë të shquar të Odës së Avokatëve do të duhet të jenë anëtarë të Këshillit Drejtues dhe Programor të Akademisë. Në publikimin “Përmirësimi i sistemit të pengesave dhe kontrolleve në Republikën e Maqedonisë: Kontrolli gjyqësor i pushtetit ekzekutiv”, Akademia është vlerësuar me notën më të mirë (2,97 nga 5) në krahasim me gjykatat (2,42 nga 5), prokuroritë (2,34 nga 5), Këshilli Gjyqësor (1,78 nga 5) dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë (1,77 nga 5)³⁹

Shërbimi gjyqësor

Në pjesën për realizimin e të drejtave të shërbimit gjyqësor, mund të konstatohet se ekziston kthim pas në të drejtat e tyre, sidomos për shkak të ndryshimeve ligjore në Ligjin për Shërbimin Gjyqësor të cilat i përforcojnë kriteret për vlerësim të nëpunësve gjyqësorë, pa u bërë paraprakisht plan për përparim në karrierë, trajnim dhe rritje të rrogës së nëpunësve gjyqësorë.

Për këto arsye, gjatë muajit mars 2016, nëpunësit gjyqësorë mbajtën një grevë treditore për shkak të pakënaqësive nga ndryshimet e Ligjit për Shërbimin Gjyqësor, të miratuar pa diskutim publik dhe me procedurë të shkurtuar, mosrritjen e rrogave në madhësi prej 5%, përkundëjt rritjes së madhësisë së kompensimeve për dezhurne dhe punë mbi kohë të gjykatësve dhe prokurorëve publikë prej 35%. Edhe përkrah grevës së mbajtur, nuk kishte reagim përkatës nga Ministria e Drejtësisë, e cila është kompetente të propozojë ndryshime të ligjit për shërbimin gjyqësor.

³⁸ http://epi.org.mk/docs/Mrezha-23_monitoring-izvestaj-15-30%2012%202015.pdf.

³⁹ Dr. Tane Talevski, dr. Marko Kmeziq, mr. Lura Pollozhani “Përmirësimi i sistemit të pengesave dhe kontrolleve në Republikën e Maqedonisë: Kontrolli gjyqësor i pushtetit ekzekutiv”, Instituti për Politikë Evropiane (PE) - Shkup, mars 2016, gjendet në: http://epi.org.mk/docs/D4V_Democracy%20and%20Rule%20of%20Law_mk.pdf (f.25)

Mandej, mësymja e madhe e kuadrove të reja, jo të kualifikuara sa duhet në administratën gjyqësore nëpërmjet mobilizimit ndikon në zvogëlimin e cilësisë së punës së gjykatësve dhe gjyqësorit në përgjithësi. Duhet të ndalojë mënyra e tillë e regrutimit të administratës gjyqësore dhe të investohet në trajnimin e nëpunësve gjyqësorë.

Në aspektin e sigurimit të “zbatimit të shpejtë të të gjitha vendimeve të GjEDNj-së kundër shtetit”, miratimi i planeve aksionare për çdo vendim dhe dorëzim të tyre në GjEDNj, që është praktikë e përhershme në RM, nuk e plotëson tërësisht kërkesën e prioritetit “zhvillim i masave praktike dhe efektive për çdo kategori të rasteve.”⁴⁰ Nuk janë vënë re masa sistematike në këtë drejtim.

Nga ana tjetër, në periudhën e kaluar, janë bërë disa intervenime ligjore të cilat nuk mund të karakterizohen drejtpërdrejtë se janë në drejtim apo në kah të kundërt me prioritetet reformuese urgjente. Një shembull i tillë është vendosja e shtesave të reja në rrogën e gjykatësve dhe të prokurorëve publikë, qëllimi i të cilave është fitimi parazgjedhor dhe servilizmi i tyre ndaj urdhrave politikë. Një shembull tjetër është mundësia që nëpunësit gjyqësorë të konkurrojnë në trajnimin e fillimit të Akademisë për Gjykatës, por vetëm si kandidatë prokurorë publikë, kurse jo për gjykatës. Nuk pati reagim më serioz ndaj grevës paralajmëruese të punëtorëve administrativë në gjyqësor, të cilët reagojnë për zgjidhjet e ligjit përkatës. Kjo kategori punëtorësh në gjyqësor mbetet e shpërfillur, edhe përkrah faktit se roli i tyre është i rëndësishëm sidomos në kushte kur po zvogëlohet numri i gjykatësve.

Duhet të veprohet urgjentisht në rishqyrtimin e sistemit të vlerësimit të punës së gjykatësve dhe të përparimit të tyre, i cili tani bazohet vetëm në të dhënat numerike për efikasitet. Intervenimet shumëvjeçare ligjore në këtë sferë sigurojnë “një derë të hapur për politizim” të gjyqësorit.

Është për t'u përshëndetur buxheti i zmadhuar për Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, por nuk duhet të lejohet, si në vitet e kaluara, nëpërmjet rebalancës buxheti i tillë të shkurtohet. Nevojitet debat publik për mundësinë që Akademia të jetë e hapur edhe për Odën e Avokatëve dhe avokatët, duke pasur parasysh se për dallim nga gjykatësit dhe prokurorët publikë, nuk është parashikuar trajnim i vazhdueshëm edhe për avokatët. Është i domosdoshëm evaluim gjithëpërfshirës i arritjeve të deritanishme të Akademisë në suazat e trajnimit të vazhdueshëm për gjykatës dhe prokurorë publikë.

Ministria e Drejtësisë duhet të propozojë ndryshime përkatëse në Ligjin për Shërbimin gjyqësor, me të cilin do të përparojnë të drejtat e punëtorëve të gjykatës, pas zbatimit të dialogut thelbësor me Sindikatën e Drejtorisë, Gjyqësorit dhe Shoqatave të Qytetarëve (SDGjShQ). Duhet të ndalohet regrutimi i nëpunësve gjyqësorë jo të kualifikuar sa duhet nëpërmjet mobilizimit dhe të investohet theksueshëm në trajnimin sistematik të nëpunësve gjyqësorë.

⁴⁰ Instituti për Politikë Evropiane, Prioritetet reformuese urgjente më të ngadalshme se restaurimi i praktikave joreformuese!, gjendet në: <http://epi.org.mk/docs/Realizacija%20na%20tne%20reformski%20prioriteti.pdf>.

2. Lufta kundër korrupsionit

Komisioni Shtetëror për Pengim të Korrupsionit

Përgatitja e programit të ri të Komisionit Shtetëror për Pengim të Korrupsionit (KShPK) vlerësohet si jotransparent, edhe pse ishin përfshirë një numër i madh shoqatash të qytetarëve të cilët punojnë në luftën kundër korrupsionit. Në procesin e përgatitjes nuk ishin përfshirë të gjithë anëtarët e Platformës kundër Korrupsionit, për shkak të përzgjedhjes e cila ekziston ndaj shoqatave të caktuara të qytetarëve të cilat janë kritike ndaj Komisionit.⁴¹ Në raport me programin paraprak, nuk ka ende një raport zyrtar mbi rezultatet e zbatimit të tij, që është një prej kërkesave kryesore të shoqatave të qytetarëve. Mungesa e transparencës ndodh, gjithashtu, edhe për shkak të parimit të mbajtjes së seancave të mbyllura, mosthirrjes së ekspertëve dhe bashkëpunimit jo të vazhdueshëm e sektorin qytetar. Një pjesë e shoqatave të qytetarëve ballafaqohen me mungesë të qasjes te informacionet me karakter publik të komisionit, që bën të pamundur ndjekjen e tërësishme të punës në këtë Komision.⁴² Mungesa e qasjes ekziston edhe për listat e anketave të funksionarëve shtetërorë, duke përfshirë edhe anëtarët e vetë Komisionit, të cilët në përputhje me nenin 35 të Ligjit për Pengim të Korrupsionit, janë informacione me karakter publik. Platforma e organizatave qytetare për luftë kundër korrupsionit i ka bërë thirrje publike⁴³ Komisionit që t'i shpallë listat e anketave dhe i gjithë opinionin të ketë mbikëqyrje në to, duke pasur parasysh se ato janë informacione me karakter dhe interes publik.

Puna e Komisionit mund të vlerësohet si pasive dhe seleksionuese, duke pasur parasysh se nuk ka reaguar ndaj përmbajtjes së incizimeve të shpallura, e cila zbulon keqpërdorim të pozitës zyrtare të funksionarëve të lartë shtetërorë për qëllime të ndryshme. Përmbajtja e programit të ri e reflekton vendosjen e tillë të Komisionit dhe nuk parashikon aktivitete për ballafaqim me situatën aktuale, por jep drejtime të përgjithshme për ballafaqim me korrupsionin në shtet. Një prej shkaqeve kryesore për pasivitetin e Komisionit është përzgjedhja e anëtarëve të cilët nuk janë të shquar në luftën kundër korrupsionit. Për këtë arsye shoqatat e qytetarëve kanë kërkuar të vendoset një sistem me bashkime dhe frena dhe të ndryshohet mënyra e zgjedhjes, përkatësisht anëtarët të përzgjidhen me shumicë prej dy të tretash, kurse me rekomandim paraprak nga shoqatat e qytetarëve për një pjesë të tyre. Gjatë vitit 2015 Komisioni ka marrë 124 fletëparaqitje nga qytetarët për ekzistim të elementëve të korrupsionit, kurse ka vepruar për 273 lëndë, prej të cilave janë zgjedhur vetëm 50%, përkatësisht 137 lëndë. Numrat e tillë dëshmojnë faktin se KShPK-ja nuk ka vepruar as për 10% të lëndëve krahasuar me numrin e fletëparaqitjeve për vitin 2014 (1544). Edhe pse viti 2014 ishte një vit zgjedhor dhe pritet një numër i madh fletëparaqitjesh nga qytetarët, por edhe partitë politike, megjithatë numri i lëndëve të zgjedhura nga KShPK-ja gjatë vitit 2015 është i pamjaftueshëm. Me konstatimin për rolin pasiv të KShPK-së lidhet edhe fakti se KShPK-ja ka vendosur vetëm për një rast të korrupsionit në politikë, kurse janë ngritur vetëm dy iniciativa për vendosjen e procedurës për ndjekje penale dhe dy iniciative për shkarkimin, ndryshimin dhe zbatimin e masave të tjera të përgjegjësive së personave të emëruar apo të përzgjedhur, në përputhje me nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Pengim të Korrupsionit.

⁴¹Deklaratë e dhënë në fokus-grupin nga pjesëmarrësit

⁴²Deklaratë e dhënë në fokus-grupin nga pjesëmarrëses nga Transparencë Maqedoni

⁴³Shpalljen e tërësishme të Platformës mund ta lexoni në këtë link:

<http://standard.mk/platforma-za-borba-protiv-korupcija-antikorupciska-da-ne-go-krie-imotot-na-funkcionerite/>

KShPK-ja nuk e realizon rolin e vet si trup i pavarur dhe sovran, në përputhje me Ligjin për Parandalim të Korrupsionit. KShPK duhet të ketë rol proaktiv në luftën kundër korrupsionit dhe duhet të garantojë punë të pavarur për të gjithë anëtarët, duke përfshirë edhe presidentin.

KShPK duhet ta zbatojë në mënyrë konsekuente Ligji për Pengim të Korrupsionit në pjesën e shpalljes së listave të anketës për mbartësit e autorizimeve publike, duke përfshirë edhe anëtarët e saj. KShPK duhet të mbajë seanca të hapura dhe duhet të bashkëpunojë me të gjitha organizatat qytetare të cilat luftojnë kundër korrupsionit .

Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve

Kriza politike dhe sidomos shpallja e bisedave të përgjuara e imponoi nevojë për miratim urgjent të Ligjit për Mbrojtje të Dëshmitarëve. Duke pasur parasysh faktin se Ligji ishte objekt i marrëveshjes së partive politike përgatitja dhe miratimi i tij janë bërë në mënyrë jotransparente, pa përfshirjen e opinionit ekspert. Edhe përkrah kësaj, miratimi i Ligjit mund të konsiderohet si shembull pozitiv në përpjekjet e shtetit që të ballafaqohet me korrupsionin.

Ligji është miratuar më 10.11.2015, ka hyrë në fuqi më 18.11.2015, kurse zbatimi i tij ishte paraparë të fillojë më 18.03.2016. Në Ligj ishte parashikuar ministri i drejtësisë t'i miratojë aktet nënligjore në afat prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit, por ky afat nuk ishte respektuar dhe rregulloret janë miratuar më 03.03.2016, kurse hynë në fuqi më 11.03.2016. Prolongimi i rregulloreve ka ndikuar edhe në zbatimin e vetë ligjit.

Në raport me përmbajtjen e ligjit, është shpallur mendimi se Komisioni i Venecias⁴⁴ i cili e përshëndeti miratimin e Ligjit, duke theksuar zgjidhjen ligjore është në përputhje me Rekomandimin CM/Rec (2014) të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës. Vërejtjet të cilat Komisioni i ka dhëni kanë të bëjnë me nevojën e përcaktimit të interesit publik në kontekstin e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe përcaktimin e nenit 6 i cili e rregullon paraqitjen publike të mbrojtur.

Duke pasur parasysh faktin se janë miratuar edhe aktet nënligjore, Ligji mund dhe duhet të fillojë të zbatohet dhe shteti duhet t'i sigurojë të gjitha kushtet për zbatimin e tij efikas. Nevojitet ndryshim i Ligjit për Dëshmitarët, në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias.

⁴⁴Mendimi i Tërësishëm i Komisionit të Venecias për Ligjin për Dëshmitarë gjendet në linkun e mëposhtëm: [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2016\)008-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)008-e)

3. Të drejta themelore

Të drejtat e njeriut

Avokati i Popullit

Gjatë vitit 2015 Avokati i Popullit ka pranuar 4403 parashtresa nga qytetarë që është për 154 parashtresa më tepër prej vitit të mëparshëm,⁴⁵ kurse gjatë muajve janar-shkurt 2016 ka pranuar 717. Në raport me bashkëpunimin me institucionet, Avokati i Popullit konstaton pengesë në punën e tij nga një numër më i madh institucionesh, në krahasim me vitet e mëparshme, kurse sidomos nga Ministria e Punëve të Brendshme, Kadastra e Republikës së Maqedonisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Sidomos na shqetëson mosbashkëpunimi me gjykata të caktuara, që për herë të parë është vënë re gjatë vitit 2015. Puna e lëndëve të Avokatit të Popullit dëshmon se në vend që të zvogëlohet kemi zmadhim të numrit të ankesave të qytetarëve për shkelje të të drejtave të tyre në fushën e drejtësisë. Avokati i Popullit konstaton se gjykatat administrative edhe mandej janë joefikase dhe për reformën e tyre duhet të punohet në mënyrë serioze.

Nevoja për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Avokatin e Popullit nuk shihet ende si prioritet nga shteti, prandaj mund të konstatohet se nuk respektohen Prioritetet Reformuese Urgjente për përparimin e sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Se nuk ekziston plan për përforcimin e kapaciteteve të Avokatit të Popullit vërtetohet edhe nga buxheti i lejuar për vitin 2016, i cili nga viti 2015 është zmadhuar me 1%. Avokati i Popullit na informoi se gjatë vitit 2015 ka pasur punësim vetëm të një personi në zyrën në Shkup për nevojat në pjesën e higjienës, edhe pse momentalisht nuk ka të punësuar në Mekanizmin Parandalues Nacional.

Ligji për Avokatin e Popullit duhet të ndryshojë sa më shpejt, me qëllim që të përforcohen autorizimet e Avokatit të Popullit, sidomos në pjesën e hetimit të shkeljeve, por edhe për përparimin e të drejtave të njeriut. Ndryshimet e tilla ligjore duhet të shkaktojnë edhe pavarësi më të madhe financiare të Avokatit të Popullit dhe zmadhim të kapaciteteve njerëzore, në bazë të të cilave mund të akreditohet me Statusin A në përputhshmëri me parimet e Parisit.

Tortura dhe lloji tjetër i veprimit ose dënimit të ashpër ofendues apo çnjerëzor

Gjatë vitit 2015, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka marrë pesë vendime rekorde që lidhen me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut – Ndalimi i Torturimit.⁴⁶ Në të gjitha aktvendimet bëhet fjalë për torturë të kryer nga nëpunësit shtetërorë,

⁴⁵Raporti i avokatit të Popullit për vitin 2015

http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2015/GI_2015-za_pecat.pdf

⁴⁶Asllani kundër Maqedonisë (Ankesa nr. 24058/13), Hajrullahu kundës Maqedonisë (Ankesa nr. 37537/07), Andonovski kundër Maqedonisë (Ankesa nr. 24312/10), Kitanovski kundër Maqedonisë (Ankesa nr. 15191/12) dhe Ilievska kundër Maqedonisë (Ankesa nr. 20136/11).

d por edhe përkrah faktit se këto raste ishin paraqitur në prokurori, për to ose nuk ka pasur asnjë lloj hetimi, ose hetimi ka qenë tërësisht joefektiv prandaj të dëmtuarit në një pjesë të rasteve kanë bërë padi private të cilat janë hedhur poshtë ose nuk janë shqyrtuar sa duhet nga gjykatat. Për shkak të këtij veprimi të prokurorive dhe gjykatave, më tepër janë shkelur të drejtat e ankuesve, kurse Republika e Maqedonisë vetëm në bazë të këtij neni të Konventës është dënuar me rreth 50.000 euro, mjete që duhen t'u paguhen i dëmshpërblim viktimave.

Edhe pse këto evenimente kanë ndodhur midis viteve 2004 dhe 2009, Komiteti i Helsinkit në tri vitet e fundit ka regjistruar një duzinë rastesh të ngjashme të cilat janë të ngjashme me rastet e përshkuara dhe për të cilat prokuroria nuk ka zbatuar hetim efektiv. Shembujt e tillë janë tortura mbi tre të paraburgosur nga Shqipëria të cilët janë lidhur me pranga për radiator, ⁴⁷ i paraburgosuri i rrahur i cili është urdhëruar të zhvishet lakuriq në tualetin e paraburgimit, ⁴⁸ qytetari i rrahur brutalisht në rrugë në Ohër nga policia, ⁴⁹ personi i burgosur i cili pas një sulmi nga polici i burgut humbi një veshkë dhe tëmthin, ⁵⁰ sulmi i një numri të madh policësh mbi qytetarët e bashkësisë rome në lagjen Topaana, ⁵¹ rrahja e një djali të pafajshëm në stacionin policor në Demir Hisar, ⁵² rrahja e fëmijëve të mitur romë nga Njësia Policore "Alfa", ⁵³ lidhja me litar e Leonit të mitur të vendosur gabimisht në institucionin për persona me aftësi të kufizuara fizike ⁵⁴ dhe përdorimi i ujit të papastër në Burgu e Kumanovës. ⁵⁵

Gjatë muajit mars 2016, Komiteti i Helsinkit dërgoi 49 kërkesa për informim në lidhje me lëndët e regjistruara për të cilat kanë vepruar prokuroritë publike dhe gjykatat sipas nenit 142 (Këqtrajtim dhe veprim e dënim tjetër i ashpër, çnjerëzor ose ofendues) për një periudhë prej 6 vjetësh, përkatësisht nga viti 2009 deri në vitin 2015. Informacione kthyesë janë marrë nga 21 (prej 26 gjithsej) gjykata dhe 20 (prej 23 gjithsej) prokurorish themelore. Sipas përgjigjeve të marra nga gjykatat, për një periudhë prej gjashtë vjetësh ato kanë vepruar për 22 lëndë sipas nenit 142 dhe për 56 lëndë sipas nenit 143. Sipas nenit 142 nuk ka pasur asnjë vendim dënues me të cilin ndonjë të jetë dënuar me dënim me burg për torturë. Janë marrë 8 vendime me dënim me kusht, si masë alternative. Në lidhje me neni 143, është marrë vetëm një vendim me dënim me burg të përcaktuar (6 muaj për një inkasant në NP për Rrugët) dhe 16 vendime me dënim me kusht. Prokuroritë themelore publike kanë vepruar mbi 32 lëndë për torturë. Vetëm në 7 prej tyre ka pasur hetim dhe është ngritur akuzë. Sipas nenit 143 (këqtrajtim gjatë kryerjes së shërbimit) prokuroritë kanë vepruar për 138 lëndë, hetim ka pasur për 30, kurse akuzë është ngritur për 22 lëndë.

⁴⁷ Komiteti i Helsinkit, Raporti kuartal (tetor - dhjetor 2012): <http://www.mhc.org.mk/reports/99>

⁴⁸ Komiteti i Helsinkit, Raporti mujor - mars 2013: <http://www.mhc.org.mk/reports/124>

⁴⁹ Komiteti i Helsinkit, Raporti kuartal (prill - qershor 2013): <http://www.mhc.org.mk/reports/145>

⁵⁰ Ibid

⁵¹ Ibid

⁵² Komiteti i Helsinkit, Raporti dymujor (korrik - gusht 2013): <http://www.mhc.org.mk/reports/149>

⁵³ Komiteti i Helsinkit, Raporti dymujor (prill - maj 2014): <http://www.mhc.org.mk/reports/219>

⁵⁴ Komiteti i Helsinkit, Raporti njëmujor - qershor 2014: <http://www.mhc.org.mk/reports/237>

⁵⁵ Komiteti i Helsinkit, 20 tetor 2014: <http://www.mhc.org.mk/announcements/254>

Më 28 mars 2016 PPS mbajti konferencë për shtyp ku shpalli se është dhënë urdhër për zbatim të procedurës hetuese për veprim çnjerëzor gjatë privimit nga liria të Kryetarit të Partisë Të Bashkuar për Maqedoninë – të dëmtuarin Lube Boshkovski. PPS-ja informoi se në bazë të dëshmimeve të mbledhura ka dakë dyshim i bazuar se të gjithë të involvuarit, përveç të dëmtuarit, kanë qenë shumë të interesuar, që i gjithë opinioni ta shikojë paskrupullin e një pjese të forcave të policisë – alfat, gjatë arrestimit të një kundërshtari politik të partisë në pushtet, që në atë periudhë ka udhëhequr me policinë. PPS-ja ka theksuar se sjellja e tillë, përkatësisht tortura dënohet me të gjitha standardet ndërkombëtare dhe sipas Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë – neni 142 i KP-së – Keqtrajtimi dhe veprimi tjetër i ashpër, çnjerëzor apo ofendues dhe dënimi. Për rastin konkret janë 7 persona, prej të cilëve një pjesë janë ende të punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Kundër të gjithë personave të cilët janë në marrëdhënie pune në Ministrinë e Punëve të Brendshme në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup, PPS-ja ka dorëzuar propozim për shqiptim të masës së kujdesit – ndalim për ndërmarrje të aktiviteteve të caktuara të punës të cilat lidhen me veprën penale.

Pushtetet të zbatojnë politikë të tolerancës zero për akte të torturës nga personat zyrtarë. Pasiviteti i prokurorisë publike në raste të torturës, sidomos kur kryhet nga nëpunësit policorë çon te mosbesimi i qytetarëve në sistemin juridik dhe te mosparaqitja e veprave të tilla. Është koha për ballafaqim me fenomenin e pandëshkueshmërisë dhe solidarizimit të Prokurorisë Publike dhe gjyqësorit me policinë. Fokusi kryesor duhet të drejtohet kah viktimave të torturës për të cilat shteti nuk siguron ende mbështetje përkatëse juridike, mjekësore, psikologjike dhe sociale. Për arritjen e këtij qëllimi është e domosdoshme implementimi urgjent i Direktivës EU 2012/29 për vendosjen e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe brojtjen e viktimave të krimit.

Burgje dhe paraburgim

Gjatë muajit mars 2016, Komiteti i Helsinkit te Drejtori e Zbatimit të sanksioneve ka dorëzuar kërkesë për qasje te informacionet me karakter publik që lidhen me kapacitetin dhe numrin e personave në burgje, paraburgime, personat e dënuar të cilët vuajnë dënim me burg dhe personat e paraburgosur. Sipas përgjigjes, me gjendjen nga 12 prilli 2016, numri i përgjithshëm i personave të cilët gjenden në ndonjë prej trembëdhjetë institucioneve të burgjeve e llojit të tillë është 3.446. Prej tyre 3.159 janë persona të cilët vuajnë dënimin me burg, kurse 287 janë persona të paraburgosur. Në Shtëpinë Edukuese-Përmirësuese për të Mitur në Tetovë gjenden 28 të mitur. Kapaciteti i përgjithshëm për personat e dënuar është 2.26, që do të thotë se ekziston mbingarkesë prej 156%, përkatësisht mesatarisht 156 persona gjenden në kushte hapësinore për 100 persona. Në lidhje me kapacitetet në paraburgim, ato janë për 450 persona, kurse në to qëndrojnë 287 persona, përkatësisht më pak persona sesa kapaciteti i përgjithshëm i institucioneve. Sipas të dhënave të Drejtorisë për Zbatimin e Sanksioneve, më alarmante është gjendja në Burgun e Strumicës, që ka kapacitet prej 62 personash, kurse qëndrojnë 150 persona, përkatësisht mbingarkesa është 242%.

Mbingarkesë prej 200% ka edhe në Burgun e Tetovës, kurse mbi 170% ka në ShPN Idrizovë dhe burgjet në Shtip dhe Gjevgjeli. Sipas Drejtorisë për Zbatim të Sanksioneve numri i personave të dënuar që vuajnë dënimin me burg nga viti 2010 deri në vitin 2016 është zmadhuar me 46%.⁵⁶

Burgjet janë me kushte substandarde për jetesë, në kundërshtim me shumicën e dokumenteve ndërkombëtare dhe vendase. Një nga problemet themelore i cili mbijeton vite me radhë është mbingarkesa, që e rrezikon pavarësinë, kurse njëkohësisht e shkel edhe dinjitetin e njerëzve, duke pasur kushte çnjerëzore dhe johumane për jetesë në institucionet e burgjeve. Mekanizmat për mbikëqyrje në këto institucione nuk janë funksionalë. Trajtimi të cilin e marrin personat shpesh është çnjerëzor dhe është në kundërshtim me parimin e ndalimit absolut të torturës nga institucionet.

Projekti për Rikonstruksion të institucioneve penitenciare dhe edukuese duhej të fillonte në vitin 2011, por deri më sot përveç burgut të ri Burgu Kumanovë, i cili nuk është ndërtuar sipas standardeve për institucion të këtij lloji,⁵⁷ nuk ka përfunduar rikonstruksioni i planifikuar në asnjë burg tjetër apo shtëpi edukuese.

Rendi në burgje zbatohet shumë pak ose nuk zbatohet fare. Personat e dënuar që i drejtohen Komitetit të Helsinkit më shpesh ankohen për mbrojtjen shëndetësore jo të përshtatshme, mbingarkesën, mungesën e efikasitetit të ndihmës juridike, moszbatimin e programeve për risocializim, mungesa e programeve arsimore, mungesa e higjienës, mungesa e aktiviteteve, pamundësia të kalohet më tepër se një orë në hapësirë të hapur, korrespondenca e kufizuar etj. Nuk ekzistojnë programe për personat e dënuar me burg të përjetshëm.

Sistemi për ankesa nga personat e dënuar dërguar drejtorëve të burgjeve, Drejtorisë për Zbatim të Sanksioneve dhe gjykatave është tërësisht jofunksional. Komisioni Shtetëror për Kryerje të Mbikëqyrjes në institucionet ndëshkimore-përmirësuese dhe edukuese-përmirësuese i paraparë me Ligjin për Zbatimin e Sanksioneve⁵⁸ është formuar vetëm në letër⁵⁹ dhe nuk funksionon. Mbikëqyrja nga gjykatësit për zbatimin e sanksioneve është gjithashtu jofunksionale. Sipas kësaj, përveç Avokatit të Popullit, fjalët e të cilit nuk janë të obligueshme, nuk ekzistojnë mekanizma për kontroll të pavarur as të burgjeve, as të Drejtorisë për Zbatim të Sanksioneve. Nga viti 2011 Drejtoria në mënyrë të vazhdueshme nuk i ka lejuar organizatat joqeveritare dhe mediat që t'i vizitojnë burgjet dhe të bisedojnë me personat e dënuar.

Të nxitur nga vendimet për abolicion të marra nga Presidenti Ivanov, 106 të burgosura kanë dërguar kërkesë për falje të tyre. Me letrën e tyre u bashkëngjiti gjithashtu një kërkesë e tillë e mbi 2000 të burgosurve të pjesës për meshkuj. Presidenti Ivanov me letër e ka refuzuar

⁵⁶ „2.157 në vitin 2010, 3.159 në vitin 2016. raporti Vjetor i Drejtorisë për Zbatimin e Sanksioneve http://www.pravda.gov.mk/tekstoviuus.asp?lanq=mak&id=qodizv_krahasuar+me+informimin+e+dërguar+te+Komiteti+i+Helsinki+në+prill+të+vitet+2016.

⁵⁷ Berber, salla për ritualet fetare, klasa dhe biblioteka janë jofunksionalë. Burgu nuk ka sistem për furnizim me ujë as infrastrukturë për ujërat e zeza. Uji që përdoret për t'u pirë, gatuar, larë sillet me cisterna dhe merret nga pusët në rrethinë. Më tepër për problemet në Burg: <http://www.mhc.org.mk/announcements/254>.

⁵⁸ Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 2/2006 и 57/2010.

⁵⁹ Vendim i Qeverisë së RM-së për formim të Komisionit "Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 111/10.

kërkesën e të burgosurave, me shpjegim se qëllimi i vendimit të tij “nuk është falja e kriminelëve, por të ndihmojë në vendosjen e rendit në shtet”. Për kërkesat për falje të dorëzuara nga të burgosurit, Ivanovi nuk ka dhënë ende përgjigje. Pas përgjigjes së tillë të burgosurat kanë paralajmëruar grevë urie, kurse të burgosurit protestë, e cila megjithatë nuk u mbajt.

Gjendja me mbingarkesën e burgjeve dhe trajtimin e të burgosurve është alarmuese. Është e domosdoshme marrja e masave nëpërmjet ndryshimit të politikës së zbatimit të sanksioneve penale dhe zbatimit të paraburgimit. Aktivitetet e parapara në Projektin për rikonstrukcion të institucioneve penitenciare duhet të përshpejtohen. Mbikëqyrja administrative dhe gjyqësore duhet të përforcohet. Organizatat joqeveritare dhe mediat duhet të kenë mundësi t'i vizitojnë lirisht burgjet dhe të informojnë për kushtet e jetës në to.

E drejta e respektimit të jetës private dhe familjare dhe komunikimeve

Pas shpalljes së skandalit me bisedat e përgjuara në mënyrë jolegale, Kuvendi i RM-së, me propozim nga Qeveria e RM-së, në korrik të vitit 2015 e ka suspenduar procesin e lustracionit, por ai mbetet aktiv për të gjithë personat për të cilët deri atëherë janë marrë vendime, deri në përfundimin juridik të procedurës. Edhe përkrah rezultatit të tillë, mbetet përfundimi se procesi i pastrimit me të shkuarën duhet të bazohet në parimet e ligjeve dhe drejtësisë. Në kundërshtim me këto postulate, lustracioni në Maqedoni ishte shndërruar në shembull klasik të procedurës së inkuizitore ku personat e akuzuar nuk janë dëgjuar dhe nuk kishin mundësi të mbroheshin. Si rrjedhim, për një sërë profesioneve si gazetarë, profesorë dhe të tjerë, rezultati i kësaj procedure ka qenë i barabartë me sanksionin dënues të Kodit Penal – ndalim i kryerjes së profesionit, veprimtarisë dhe obligimit. Gjykata Administrative nuk e ka siguruar sekretin e të dhënave personale, mbrojtjen e integritetit personal, respektimin e të privatësisë, jetës familjare, dinjitetit dhe reputacionit, prandaj disa persona të lustruar drejtësinë e kërkuan në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në janar 2016, Gjykata Evropiane ka marrë një vendim me të cilin vërtetoi se procesi i lustracionit në Republikën e Maqedonisë është kryer në kundërshtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.⁶⁰

Në janar të vitit 2016, ka pasur 38 lëndë aktive para këtij Komisioni dhe 39 lëndë para Gjykatës, si dhe lëndët të cilat janë në GjEDNj.⁶¹

Komiteti i Helsinkit të Gjykatës Administrative ka dorëzuar kërkesë për qasje të informacionet me karakter publik që lidhet me numrin e lëndëve aktive për të cilat gjykata vepron ose ka vepruar dhe janë në procedurë ankimi para Gjykatës Administrative të Lartë, të formuara pas padisë së dorëzuar për vendimet e Komisionit për Verifikim të fakteve në bazë të Ligjit për Lustracion dhe numrit të lëndëve të përfunduara që janë në fuqi sipas këtij ligji. Sipas përgjigjes, gjatë vitit 2012, janë dorëzuar (8) tetë padi kundër vendime të Komisionit për Verifikim të Fakteve dhe për të gjitha janë marrë vendime, kurse kundër gjashtë (6)

⁶⁰ Ivanovski kundër Maqedonisë (Ankesa nr. 29908/11).

⁶¹ Të dhëna nga Instituti për të Drejtat e Njeriut – nga ndjekja sistematike e lustracionit dhe nëpërmjet kërkesës për qasje të informacionet me karakter privat

vendimeve të Gjykatës Administrative janë dorëzuar ankesa te Gjykata Administrative e Lartë dhe janë marrë vendime për të gjashta ankesat. Gjatë vitit 2013, janë dorëzuar 30 padi gjithsej kundër vendimeve të Komisionit për Verifikim të Fakteve, dhe për të tridhjeta janë marrë vendime, kurse kundër 19 vendimeve të Gjykatës Administrative, janë dorëzuar ankesa te Gjykata Administrative e Lartë dhe janë marrë vendime për të 19 ankesat. Gjatë vitit 2014 janë dorëzuar nëntë (9) padi gjithsej kundër vendimeve të Komisionit për Verifikim të Fakteve, dhe për të 3 (tre) padi janë marrë vendime, kurse kundër asnjë vendimi prej tyre nuk është dorëzuar ankesë te Gjykata Administrative e Lartë. Gjatë vitit 2014 janë dorëzuar 20 padi gjithsej kundër vendimeve të Komisionit për Verifikim të Fakteve, dhe për të 3 (tre) padi janë marrë vendime, kurse kundër asnjë vendimi prej tyre nuk është dorëzuar ankesë te Gjykata Administrative e Lartë. Gjatë vitit 2014 dhe 2015 asnjë lëndë nuk ka përfunduar me vendim të plotfuqishëm. Sipas përgjigjes së Gjykatës Administrative, për kërkesat e fundit të dorëzuara në vitin 2014 dhe 2015, gjykata vendos ose ka vendosur më gjatë se një vit. Veprimi i tillë është në kundërshtim me Ligjin për Lustracion i cili parashikon urgjencë në vendimarrje.

Shpallja e bisedave të përgjuara ishte shkas për miratimin e Ligjit për Mbrojtje të Privatësisë, prodhim i Marrëveshjes së Përzahinos, i miratuar me procedurë të shkurtuar, pa diskutim publik dhe me konsensus në Kuvend. Sipas këtij Ligji, ndalohet shpallja e materialeve të përgjuara jolegale nga viti 2008 deri në 2015, përveç se ato që anë shpallur. Ligji parashikon dënime me burg nga një muaj deri në një vit për secilin që do të shpallë materialet e pashpallura. Megjithatë, ligji parashikon se nëse ndodh një gjykim i tillë, gjykatat janë të obliguara ta respektojnë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata Evropiane është shprehur⁶² se liria e informimit i mundëson opinionit një nga mënyrat më të mira për formim të mendimit për politikanët. Sipas Gjykatës⁶³, e drejta e privatësisë është e ndryshme për politikanët dhe për qytetarët e tjerë, përkatësisht politikanët me vetëdije i ushtrohen një kontrolli të drejtpërdrejtë para gazetarëve dhe opinionit dhe duhet të tregojnë tolerancë më të madhe për zbulimin e detajeve nga jeta e tyre. Gjykata thekson se politikanë nuk duhet në asnjë mënyrë t'ua marrin gazetarëve rolin e "rojës publike". Për këtë ligj dha mendim edhe Komisioni i Venecias, i cili konsideron se nëpërmjet Prokurorisë Speciale Publike e cila i ka të gjitha materialet, shteti nuk duhet të lejojë të krijohen forume dhe institucione të mbyllura të cilat do të kishin të drejtën ekskluzive për qasje, hetim dhe përdorim të informacioneve. Roli i gazetarëve gjatë shpalljes së materialeve duhet të jetë i kufizuar vetëm te të dhënat kriminale, por në asnjë rast te jeta private dhe familjare. Përfundimi i Komisionit të Venecias është se nevojitet "rishqyrtim i thellë" i Ligjit për Mbrojtje të Privatësisë.

⁶² Linges kundër Austrisë (Ankesa nr. 9815/82)

⁶³ Tinkall kundër Turqisë (Ankesa nr. 41/1997/825/1031)

Regjistri i qytetarëve që kaluan procesin e lustracionit, që gjendet në faqen e internetit të Komisionit për Verifikim të Fakteve, si dhe vendimet për këta persona duhet të anulohen menjëherë dhe të hiqen nga interneti.

Gjykata Administrative duhet të veprojë në përputhje me Ligjin dhe ta respektojë urgjencën e procedurës në lëndët e lustracionit. Gjatë marrjes së vendimeve për këto lëndë duhet të kihet parasysh jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Është e nevojshme rishqyrtimi i Ligjit për Mbrojtje të Privatësisë, në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias. Por, edhe pa rishqyrtimin e tillë, sipas Kushtetutës sonë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara (siç është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut) janë pjesë e rendit të brendshëm juridik dhe nuk mund të ndryshohen me ligj.

Liria e tubimit dhe shoqërimit

Gjatë vitit 2015 shpesh herë është kufizuar e drejta e tubimit të lirë gjatë mbajtjes së tubimeve të qeta dhe protestave publike. Fuqia jo e njëtrajtshme dhe e tepërt nga policia, është përdorur gjatë protestave që u mbajtën më 5 maj 2015, kurse në protestat të cilat vijuan pas kësaj date, nëpunësit policorë në mënyrë të pabazuar e kufizuan të drejtën e lëvizjes së lirë, por njëkohësisht edhe të drejtën e tubimit publik.

Prej të gjitha shkeljeve të dhëna nga policia, prokuroria publike deri më tani nuk ka ngritur asnjë procedurë me obligim zyrtar kundër nëpunësve të policisë. Për ngjarjen në Bibliotekën “Vëllezërit Milladinovci” është dorëzuar fletëparaqitje penale në prokurori nga Partia Liberale-Demokratike, kurse prej personave mbi të cilët ishte përdorur forcë e jashtëzakonshme nga policia vetëm një dorëzoi fletëparaqitje penale për Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës. Edhe përkrah seriozitetit të veprimeve, prokuroria publike nuk e ka informuar ende publikun për rezultatet e hetimit dhe se a është iniciuar procedurë gjyqësore kundër nëpunësve policorë të dyshuar.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2015, vazhduan protestat e gjimnazistëve të organizuara nëpërmjet lëvizjes “Plenumi i gjimnazistëve”. Më 21.11.2015 u mbajt një marsh i madh protestues i gjimnazistëve kundër reformave të keqija në arsim, për shkak të të cilave nxënësit dhe prindërit e tyre paraqitën shumë kërcënime serioze nga drejtorët dhe të punësuarit në shkollat e mesme. Shumë shqetësuese ishin të dhënat për mbylljen e nxënësve në shkolla nga personat zyrtarë, nëpërmjet mbylljes së klasave dhe dyerve të shkollave të mesme, si edhe fakti që media të caktuara informuan se gjimnazistët kanë marrë kompensim në të holla për pjesëmarrje në protestë. Me këtë është bërë shkelje e nderit dhe reputacionit të fëmijëve të cilët duan ta shprehin pakënaqësinë nga reformat në arsim. Mbyllja e fëmijëve në shkolla me qëllim që të mos marrin pjesë në marshin protestues është privim i kundërligjshëm nga liria, i cili është i ndaluar në përputhje me Kodin Penal të republikës së Maqedonisë.⁶⁴

⁶⁴Në neni 140 paragrafi 3 të Kodit Penal thuhet se “nëse privimin e kundërligjshëm nga liria e kryen person zyrtar me keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve zyrtare, do të dënohet me burg nga gjashtë deri në pesë vjet”. Në bazë të këtij neni ekziston mundësi prokuroria publike të veprojë pas dëgjimit të fjalëve dhe t'i hetojë informacionet për privim nga liria të gjimnazistëve.

Gjatë muajve shkurt dhe mars 2016 janë mbajtur shumë protesta si reagim ndaj vendimit të Gjykatës Kushtetuese që të hapë procedurë për vlerësim të ndryshimeve të Ligjit për amnisti të vitit 2009. Domethënë, me shfuqizimin e këtyre ndryshimeve ligjore u shfuqizua edhe kufizimi i Presidentit të shtetit që të mos amnistojë persona të dënuar për mashtrime zgjedhore. Protesta që duhej të mbahej më 15 mars 2016 menjëherë para miratimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese ishte ndaluar nga një grup qytetarësh – kundërprotestues, të udhëhequr nga lideri i partisë GROM, Stevço Jakimovski. Duke pasur parasysh faktin se protesta e planifikuar ishte paraqitur rregullisht në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe ishte shpallur në media, kurse mandej vendi i mbajtjes së protestës ishte zënë nga persona të tjerë me qëllim krejtësisht të kundërt, mund të konstatohet se ekzistojnë indikacione serioze për kryerje të veprës penale Ndalim apo pengim të protestës publike – neni 155 i Kodit Penal. Prokuroria Publike as në këtë rast nuk e informoi opinionin se a ka vepruar sipas obligimit zyrtar dhe a ka bërë hetim kundër organizatorit dhe pjesëmarrësve në kundërprotestë.

Si reagim ndaj vendimit të Presidentit të RM-së, Gjorgje Ivanov, amnisti kolektive e 57 personave të dyshuar, nga qeveria dhe opozita, kundër të cilëve janë ngritur fletëparaqitje penale dhe janë iniciuar procedura penale, qytetarët filluan të protestojnë në mënyrë masive në mbarë vendin. Në periudhën e kaluar janë arrestuar 15 persona, 11 prej të cilëve u është shqiptuar sanksion dënues për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Shkelje të Rendit dhe Qetësisë Publike, demok kanë vepruar në kundërshtim me urdhrin e organit kompetent shtetëror apo të personit të autorizuar zyrtar të organit shtetëror për ndalim të tubimit dhe qëndrimit në një vend të caktuar. Të 13 personat janë mbajtur në stacionin policor deri në 24 orë, edhe pse personat të cilëve u është shqiptuar sanksioni ndëshkues për shkak të shkeljes së kryer sipas nenit 50 paragrafi 3 të Ligjit për Policinë mund të mbaheshin maksimum deri në 12 orë. Katër persona të nxjerrë para gjykatësit për procedurën e mësipërme u është caktuar paraburgim shtëpie në kohëzgjatje prej 8 ditësh, i cili mandej është zgjatuar në 30 ditë. Këta persona janë akuzuar për kryerje të veprës penale “Pjesëmarrje në turmë që ka kryer vepër penale” nga neni 385 paragrafi 1 i KP. Për këtë vepër penale parashikohet dënim në të holla ose burgim deri në 3 vjet, se konsiderohet për vepër më të lehtë penale, për të cilën në parim nuk duhet të përcaktohet masa paraburgim shtëpiak, përkatësisht më kompetent do të ishte shqiptimi i masave më të buta për kujdes (p.sh. obligim i të akuzuarit të paraqitet kohë pas kohe te personi zyrtar i caktuar). Me thirrjen e personave të cilët kanë marrë pjesë në protesta kryhet trembje e personave të thirrur në biseda, megjithatë edhe trembje e personave të tjerë, të cilët marrin dhe do të marrin pjesë në protesta. Vendimi për paraburgim shtëpiak, ndikon sidomos mbi kufizimin e të drejtës së protestës, për faktin se si arsyetim për përcaktim të kësaj mase është vendosur se të paraburgosurit mund ta përsëritin veprën penale duke pasur parasysh se janë paralajmëruar protesta të reja.

Gjithashtu, vendimet për paraburgim apo paraburgim shtëpiak si dhe për ngritjen e procedurave penale kundër këtyre personave mund të konsiderohen edhe si paralajmërim për qytetarët e tjerë të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në protestat të cilat po mbahen në këtë periudhë. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 21 të Kushtetutës së RM-së, ku thuhet se qytetarët kanë të drejtë të mblidhen dhe të shprehin protestë publike pa

paralajmërim paraprak dhe pa leje të veçantë dhe shfrytëzimi i kësaj të drejte mund të kufizohet vetëm në kushte të luftës dhe të gjendjes së jashtëzakonshme që nuk është rast në këtë situatë. Për krahasim, kundër pjesëmarrësve të protestave të dhunshme para Komunës Qendër, të cilat u mbajtën në vitin 2014, nuk është ngritur asnjë procedurë gjyqësore, prandaj mund të konstatohet se ekziston drejtësi selektive.⁶⁵

Në pjesën e lirisë së tubimit vihet re trysni e zmadhuar mbi shoqatat e qytetarëve nga intitucionet shtetërore, por edhe mediat proqeveritare nëpërmjet t.a. fushata të zeza.⁶⁶ Shembull eklatant për trysninë e tillë është mbikëqyrja tendencioze financiare të shoqatës së qytetarëve MOST nga Drejtoria e Policisë Financiare, në periudhën kur duhej të jepej mendim a është i përgatitur shteti që të zbatojë zgjedhje të ndershme dhe të pavarura. Policia Financiare informoi⁶⁷ se vepron me paraqitje për transaksione të dyshimta të shoqatës së qytetarëve MOST në llogari të dyshimta të personave fizikë nga shtetet Liban, Jordani, Kirgistan, Shqipëri dhe Tunizi, për të cilët MOST informoi se janë persona të angazhuar – ekspertë për proceset zgjedhore.

Shteti duhet të sigurojë respektimin e të drejtës së tubimit në mënyrë që ajo të mos kufizohet as nga policia as nga ndonjë grup tjetër qytetarësh – kundërprotestues në rastet kur bëhet fjalë për protestë të rregullt të paraqitur, në përputhje e Ligjin për Tubime Publike. Gjykatësit të cilët vendosin për përcaktimin dhe vazhdimin e masave për sigurim të pranisë ta marrin parasysh faktin se bëhet fjalë për vepra penale për të cilat nuk duhet ngritur masa paraburgim apo paraburgim shtëpiak, si dhe fakti se bëhet fjalë për persona të cilët më parë nuk kanë kryer vepër penale. Shteti nuk duhet të ushtrojë presion mbi punën e shoqatave të qytetarëve të cilat duhet të jenë korrigjues i pushtetit dhe të punojnë për interesin publik.

Grupet e lëndueshme dhe parimi i mosdiskriminimit

Edhe përkrah faktit se kanë kaluar pesë vjet nga zbatimi i Ligjit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi dhe formimi i Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi, nuk mund të flitet ende për një mbrojtje efektive në pjesën e diskriminimit, sidomos kur bëhet fjalë për grupet e margjinalizuara. Pikat kryesore të cilat lidhen me qasjen te drejtësia të viktimave të diskriminimit përkatësisht lirimi nga shpenzimet gjyqësore për ngritjen e procedurës gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi, pavarësia e Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe përfshirja e orientimit seksual dhe identitetit gjinor si baza të diskriminimit, mbetën të pandryshuara.

⁶⁵ Shpallje e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM për protesta <http://www.mhc.org.mk/announcements/400#.VysJtR97IU>

⁶⁶ Për fushatën kundër shoqatave kritike të qytetarëve mund të lexoni në analizën e NVO Infocentar - "Qytetarët kritikë shënjestër e vazhdueshme e sulmeve të mediave proqeveritare http://nvoinfocentar.mk/analiza_kritikite_graqjani_postojana_meta_na_napadi_vo_provladinite_mediumi/

⁶⁷ Shpalljen e tërësishtme të Drejtorisë për Polici Financiare mund ta lexoni në linkun e mëposhtëm:

<http://kurir.mk/makedonija/vesti/finansiska-politsija-most-ne-dozvoluva-uvide-vo-dokumentatsijata-i-odbiva-sekakra-sorabotka/>

Në muajin janar 2016 Kuvendi i RM-së, nëpërmjet një procedure jotransparente i ka zgjedhur anëtarët e Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Pjesa më e madhe e anëtarëve⁶⁸ nuk kanë përvojë të mëparshme në këtë fushë dhe në punën me grupe të lëndueshme, kurse një pjesë e tyre janë të lidhur me koalicionin qeveritar ose janë mbështetës të hapur të politikave të pushtetit, sidomos të politikave të cilat nuk lejojnë trajtim të barabartë të pakicave etnike në shtet. Me përzgjedhjen e kryer është e qartë tendenca për partizimin edhe më të madh të këtij trupi, i cili sipas standardeve ndërkombëtare dhe vendase duhet të jetë i pavarur. Përbërja e tillë e Komisionit nuk është në përputhje me frymën e respektimit të dallimeve, sidomos sepse ka vetëm një grua anëtare dhe nuk përfshihen përfaqësues nga bashkësitë më të vogla etnike.

Mbrojtja gjyqësore në rast të diskriminimit filloi të zbatohet gjithnjë edhe më tepër, por pjesa më e madhe e procedurave të ngritura gjyqësore mbështeten nga shoqatat e qytetarëve të cilat sigurojnë ndihmë juridike në rastet e diskriminimit. Ky është rezultat i mungesës së konsekuencës së Ligjit për Ndalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi në pjesën e qasjes të drejtësia, sepse nuk mundëson lirim prej shpenzimeve gjyqësore gjatë ngritjes së procedurës. Për këto arsye mund të konstatohet se qasja të drejtësia për mbrojtje gjyqësore prej diskriminimit mbetet e kufizuar. Këtë konstatim e vërtetojnë edhe përgjigjet e gjykatave në lidhje me procedurat e ngritura gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi. Domethënë, sipas përgjigjeve të marra nga gjykatat në nivel të të gjithë shtetit procedura të ngritura për diskriminim ka në Shkup, Dellçevë, Kratovë dhe Koçan. Procedurat gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi janë gëtur edhe në Manastir, por e njëjta nuk mund të përcaktohet sipas përgjigjes së Gjykatës Themelore Manastir, sepse në Sistemin AKMIS nuk ka evidencë të veçantë për konteste pune, si konteste për kompensim të dëmit apo përsëri si konteste me vlerë të vogël. Kjo gjendje u vërtetua edhe nga Gjykata Themelore Shkup 2 Shkup, e cila megjithatë ka arritur të japë informacione të detajuara mbi procedurat e ngritura gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi.

Në lidhje me grupet e lëndueshme të cilat ballafaqohen më tepër me diskriminimin mund të konstatohet se ato janë romët. Ky konstatim vjen nga diskriminimi sistematik që vazhdon të ushtrohet mbi përfaqësuesit e bashkësisë romë me kufizim të të drejtës për largim nga shtetinga Ministria e Punëve të Brendshme,⁶⁹ por edhe ndarja që ekziston ndaj fëmijëve romë arsim. Sipas konkluzioneve përfundimtare të Komitetit për Eliminim të të Gjitha Formave të në arsim. Gjendja e tillë është vërtetuar dhe nga Komiteti për Eliminim të të Gjitha Formave të Diskriminimit Rasor i Kombeve të Bashkuara, i cili e theksoi kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore dhe mbrojtjen e tyre joefikase sidomos në pjesën e lirisë së lëvizjes së romëve, mosposedimin e dokumenteve personale, situatën me fëmijët romë në rrugë dhe ndarjen në Diskriminimit Rasor të Kombeve të Bashkuara duket qartë se shteti nuk arrin ta përmirësojë gjendjen e romëve si përfaqësues të grupit më të marginalizuar në Republikën e Maqedonisë. Komiteti ka shprehur shqetësim edhe për problemin e strehimit të romëve dhe për statusin më të keq social, duke konstatuar se bashkësia etnike romë ballafaqohet më tepër me varfërinë, papunësinë dhe përjashtimin social.

⁶⁸ Më 11 janar 2016, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me 62 vota "pro" dhe me një votë "kundër", në seancën e 85 i zgjodhi: Toni Naunovski, Aleksandar Dashtevski, Aleksandar Spasenovski, Nena Nenovska-georgjievska, Jovan Ananiev, Irfan Dehari dhe Bekim Kadriu për anëtarë të Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi.

⁶⁹ Përveç organizatave qytetare, kjo dukuri është vërtetuar edhe nga Avokati i popullit, shiko Raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2015: http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2015/GI_2015-za_pecat.pdf

Personat LGBTI edhe mandej mbeten objekt i diskriminimit sistematik, për shkak të mos marrjes së veprimeve nga prokuroria publike për disa sulmeve të shumëfisha mbi Qendrën LGBTI dhe mospërfshirjen e orientimit seksual dhe identiteti gjinor në një numër të madh ligjesh me të cilat duhet të sigurohet mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe inkluzioni i tyre në shoqëri. Për shkak të gjendjes së mosdënimit, personat LGBTI nuk kanë besim në institucionet që të paraqesin shkelje të të drejtave të tyre sidomos kur bëhet fjalë për raste të diskriminimit. Ky konstatim vërtetohet edhe në hulumtimin më të ri të Qendrës për Mbështetje të LGBTI-së, që është përpjekja e parë sistematike në nivel nacional për një hulumtim të detajuar statistikor mbi qëndrimet dhe perceptimet e njerëzve LGBTI për fushat e targetuara problematike dhe mekanizmat për mbrojtje. Hulumtimi dëshmoi se 39% e anketuarve konsiderojnë se kanë qenë viktimat të diskriminimit në procesin e realizimit të mbrojtjes sociale (parandalim social, mbrojtje shëndetësore, ndihmë sociale në të holla, e drejta e strehimit social, ndihma e njëfishtë në të holla ose ndihma materiale). Megjithatë problem shtesë është edhe shkalla e ulët e paraqitjes së diskriminimit të perceptuar, ku prej atyre të cilët mendojnë se janë diskriminuar vetëm 17,6% e kanë paraqitur diskriminimin në qendrat për punë sociale, kurse 7,8% në organizata joqeveritare. Pjesa tjetër prej 74,6% nuk e kanë paraqitur aspak rastin. Madje 65,9 e të anketuarve janë përgjigjur se në jetën e tyre të deritanishme kanë qenë viktimat të dhunës për shkak të orientimit të tyre seksual dhe/ose identitetit gjinor. Prej tyre, 21,87% janë përgjigjur se kanë qenë viktimë e dhunës fizike, 42,5% janë përgjigjur se kanë qenë viktimat të dhunës psikologjike, 29,37% janë përgjigjur se kanë qenë viktimat të dhunës verbale dhe 6,25% janë përgjigjur se kanë qenë viktimat të dhunës seksuale. Shqetëson e dhëna se 18% e viktimave të dhunës, kanë qenë viktimat të minimum të tri llojeve të dhunës. Përsëri, është karakteristik problemi i mosparaqitjes, ku 71,27% e viktimave LGBTI të dhunës nuk e kanë paraqitur rastin në asnjë institucion apo organizatë.⁷⁰

Të fillojë sa më shpejt përgatitja e ndryshimeve të Ligjit për Ndalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, sidomos në pjesën e qasjes të drejtësia për viktimat e diskriminimit, përkatësisht lirim prej shpenzimeve gjyqësore për ngritje të procedurës gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi, pavarësisht së Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe përfshirjes së orientimit seksual dhe identitetit gjinor si baza të diskriminimit.

Të jepet përgjigje urgjente mbi hetimin kundër sulmuesve të Qendrës LGBTI për Mbështetje dhe njerëzve LGBTI, sepse mosdëshkimi i sulmuesve është diskriminim ndaj njerëzve LGBTI si grup i marginalizuar, i cili tërësisht e shkatërron besimin të institucionet.

Të iniciohet mbindërtimi i sistemit AKMIS me qëllim që të mund të jepen të dhënat e sakta mbi procedurat gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi dhe bazat për të cilat është kërkuar kjo mbrojtje. Të emërohen gjykatës të veçantë të cilët do të punojnë këto lëndë, siç është shembulli me procedurat gjyqësore të ngritura për shpifje dhe ofendim.

⁷⁰ Analizën e tërësishme e gjeni në këtë link: <http://lgbti.mk/uploads/3b7076e5-dc63-4b58-8bb6-ae2a46d91bc4.pdf>

Liria e shprehjes dhe pluralizmit në media

Po vazhdon praktika negative e shkeljes së Ligjit për Mediat dhe Ligjit për Shërbimet Audio dhe Audiovizuale të Mediave. Gjatë vitit 2015 në Agjencinë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale të Mediave janë dorëzuar 71 parashtresa dhe propozime, 22 janë dorëzuar nga persona juridikë (shoqata qytetarësh dhe persona të tjerë juridikë), kurse pjesa tjetër prej 49 parashtresash janë dorëzuar nga persona fizikë. Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale të Mediave ka konstatuar 244 shkelje të dispozitave ligjore prej të cilave 204 shkelje të Ligjit për Shërbimet Audio dhe Audiovizuale të Mediave dhe 40 shkelje të Ligjit për Mediat. Këta numra tregojnë rritje të shkeljeve të Ligjit për Mediat dhe Ligjit për Shërbimet Audio dhe Audiovizuale të Mediave në raport me numrin e vitit 2014, kur Agjencia ka konstatuar 179 shkelje të dispozitave ligjore. Pjesa më e madhe e këtyre shkeljeve janë kryer nga radiodifuzerë, por nuk mbeten pas edhe botuesit e mediave të shtypura dhe operatorëve të rrjeteve publike elektronike të komunikimit. Trendi negativ i shkeljes së dispozitave ligjore të cilat duhet të garantojnë lirinë e shprehjes dhe pluralizmin në media vazhdon edhe në 3 muajt e parë të vitit 2016. Nga 1 janari deri më 31 mars 2016 Agjencia ka ngritur 87 mbikëqyrje me iniciativë të vet, prej të cilave 59 të radiodifuzerëve, 5 të botuesve të mediave të shtypura, 21 të operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik. Gjatë mbikëqyrjes janë konstatuar 17 shkelje gjithsej të Ligjit për mediat dhe Ligjit për Shërbimet Audio dhe Audiovizuale të Mediave të kryera nga radiodifuzerët, 3 shkelje nga botuesit e mediave të shtypura dhe 7 shkelje nga operatorë të rrjeteve publike të komunikimit elektronik. Për t'u përshëndetur është mbikëqyrja e disa emetimeve të emisionit të "Milenko Nedelkovski shou" nga Agjencia i cili jepet në dy televizione me koncesione nacionale, ku është konstatuar shkelje e nenit 48 të Ligjit për Shërbimet Audio dhe Audiovizuale të Mediave, përkatësisht nxitje e diskriminimit, padurimit apo urrejtjes në bazë rasore, gjinore, fetare apo nacionale.

Në përgjithësi në këtë periudhë është vënë re ndryshim në informim te radiodifuzerët më të mëdhenj Sitell dhe Kanal 5, të cilët pas një periudhe të gjatë kohore (pothuajse 8 vjet) kanë ftuar përfaqësues të opozitës në intervistë në lajmet e tyre kryesore, si pjesë e zbatimit të Marrëveshjes së Përzahinës e cila midis të tjerash parashikon ndryshim dhe përmirësim të gjendjes me mediat. Edhe pse qëllimi ishte përmirësimi i imixhit të këtyre mediave, para së gjithash për opinionin e huaj, këto hapa nuk janë ndryshim i vërtetë në politikën redaktuese, por vetëm vërtetim i kontrollit shtetëror mbi ta. Dëshmia më e mirë ishte pjesëmarrja e Presidentit të Lidhjes Socialdemokratike të Maqedonisë, Zoran Zaev si i ftuar në "Ditarin" e orës 19.00 në TV Sitell, të cilin e udhëhiqte redaktori kryesor i televizionit, Dragan Pavloviq Llatas. Edhe pse intervista duhej të siguronte hapësirë për prezantim të partisë më të madhe opozitare dhe të pikëpamjeve të tyre për temat aktuale shoqërore-politike, nga redaktori i TV Sitellit u tregua raport degradues ndaj bashkëfolësit dhe mosrespektim i standardeve minimale për gazetari profesionale. Në një prej ofendimeve të drejtuara, redaktori e ofendoi edhe bashkësinë tnikë turke, e cila ditën tjetër protestoi para TV Sitellit. Në këtë aspekt, intervista e redaktorit kryesor të televizionit Sitell ishte shembull për qasje joobjektive. Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale të Mediave⁷¹ e dënoi

⁷¹http://www.avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=2609%3A2016-02-11-12-08-03&catid=88%3Asoopstenija-media&Itemid=313&lang=mk

mosrespektimin e parimeve dhe standardeve profesionale gazetareske të redaktorit kryesor të TV Sitellit. Agjencia në reagimin e vet theksoi se intervista ka qenë pa asnjë distancë profesionale, pa respektim të dinjitetit të bashkëfolësit dhe një sërë personash të tjerë të përmendur në bisedë. Duke pasur parasysh dënimin në publik të kësaj interviste, sidomos nga institucionet, shoqatat e gazetarëve dhe bashkësia ndërkombëtare, Këshilli për Etikë në Mediat në Maqedoni përgatiti Konventë për Informim Etik në Zgjedhje⁷² e cila është nënshkruar nga një numër i madh mediash, duke përfshirë edhe TV Sitell. Përmbajtja e kësaj Konvente bazohet në parimet më të rëndësishme dhe universale të profesionit, që gjenden në dokumentet dhe publikimet e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve, Iniciativës për Gazetari Etike, Fondacionit Rojters dhe Reporterëve pa Kufij.

Trendi i informimit në media në drejtim të mbështetjes qeveritare po vazhdon edhe në vitin 2016. Struktura qeveritare vazhdon t'i shfrytëzojë televizionet më të fuqishme që ta mbajë në status quo situatën në aspektin e raportit të fuqisë politike. Mund të identifikohen disa strategji: (1)shfrytëzimi i lajmeve televizive si marketing politik për Qeverinë dhe liderin e VMRO-DPMNE-së; (2) censurim i selektuar i shprehjes politike; (3) llogaritje e orkestruar e mediave me ata që nuk mendojnë njëjt⁷³

Nuk ka iniciativa për ndryshim të Ligjit për Përgjegjësi Qytetare prej shpifjes në aspektin e përkufizimeve (harmonizim me nenin 10 të GjEDNj), as ndryshim të rregullave procedurale për përjashtim të rasteve me vlerë të vogël dhe përdorim të mediacionit, siç sugjerojnë Prioritetit Urgjente Reformuese. Analiza e lëndëve të shpifjes nuk dëshmon se politikanët janë vetëkufizuar në ngritjen e padive për shpifje në krahasim me vitin e mëparshëm. Nga 1 qershori 2015 deri në fund të atij viti janë ngritur 8 lëndë të reja në të cilat pala është gazetar, kurse seancat gjyqësore janë mbajtur për 24 lëndë në vijim.⁷⁴

Në vitin 2015 janë ngritur 9 lëndë të reja për ofendim dhe shpifje. Është interesante të përmendet se sipas Gjykatës Themelore Shkup 2 Shkup, gjatë vitit 2015, në të gjitha 9 rastet e reja për ofendim dhe shpifje ku si palë shfaqen politikanët – ata shfaqen si paditës. Në vitin 2015 prej 9 rasteve gjithsej për një ka procedurë ankimi në Gjykatën e Apelit, kurse për 8 të tjerat ka procedurë para gjykatës themelore.⁷⁵

Më 1 tetor 2015, Gjykata Themelore Shtip ka marrë vendim se biznesmeni Miki Naumov e ka shkelur reputacionin dhe nderin e Zoran Zaevit. Procedurën gjyqësore Zaevi e ngriti me rastin e deklaratës së biznesmenit Naumov, në maj të këtij viti, se i ka dhënë mito me shumë prej 39 000 eurosh, në cilësinë e kryetarit të Komunës së Strumicës, kurse ka marrë si shpërblim një hapësirë atraktive në qendrën tregtare Global.⁷⁶

⁷² <http://semm.mk/novosti/2015-08-11-15-03-18/204-2016-01-27-13-41-21>.

⁷³ Këto përfundime janë marrë nga raportet e ndjekjes së përmbajtjeve të mediave, të përgatitura nga Instituti për Studime të komunikimit. Raportet e tërësishtme mund t'i lexoni në linqet e mëposhtme:

<http://respublika.edu.mk/modem/MODEM-eden%2018%20nqemvri%2023%20dekemvri.pdf>

http://respublika.edu.mk/modem/19-29-januari/Second-Monthly-report-MODEM_mk_opt.pdf

http://respublika.edu.mk/modem/06-04-mart-2016/Third-Monthly-report-MODEM_opt.pdf

⁷⁴ Nga ndjeka e NVO Infoqendrës.

⁷⁵ NVO Infoqendra, Raporti: Politikanët dhe rastet gjyqësore për ofendim dhe shpifje, NVO Infoqendër, dhjetor 2015 gjendet në:

<http://nvoinfocentar.mk/wp-content/uploads/2016/01/Politcarite-i-suds kite-slucai-za-navreda-i-kleveta1.pdf>

⁷⁶ Biznesmeni nga Shtipi pohon se i ka dhënë mito Zaevit prej 39.000 eurosh. Alfa TV 17.10. 2015. Gjendet në:

<http://www.telegraf.mk/aktuelno/makedonija/273973-alfa-tv-biznismen-od-stip-tvr-di-deka-mu-dal-mito-na-zaev-od-39-000-evra>

Gjykata Themelore Shkup 2 Shkup më 9 dhjetor gjatë gjykimit të përsëritur për padinë për ofendim dhe shpifje⁷⁷ të ngritur nga ish-ministrja e punëve të brendshme, Gordana Jankulovska, kundër Petre Shilegov nga LSDM-ja ka marrë vendim sipas të cilit Shilegov i ka paguar Jankullovsksë dëmshpërblim prej 20 mijë denarësh.⁷⁸ Paraprakisht, Gjykata e Apelit e ka shfuqizuar aktvendimin e shkallës së parë për pagim të dëmshpërblimit prej 500 mijë denarësh.

Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë kërkesën e Apostollov dhe Kostova, gazetar dhe redaktore e revistës së përjavshme “Fokus”, për mbrojtje të lirive dhe të drejtave, të cilat lidhen me lirinë e shprehjes publike të mendimit. Tekstet e shpallura në revistën e përjavshme “Fokus” nuk kishin për qëllim të shkaktojnë debat publik, por t'i shkelin të drejtat personale të paditësit Mijallkov. Njëkohësisht, Gjykata Kushtetuese konsideron se tekstet nuk i respektojnë parimet e gazetarisë hulumtuese, si dhe se burimi i informacioneve, ish-ambasador në RM, nuk mund të konsiderohet për faktor relevant.

Vendimi i tillë hap disa çështje themelore: (1) Pse gjykata konsideron se tekstet që lidhen me sjelljen e një mbartësi të funksionit publik, në këtë rast, drejtori i atëhershëm i DZK, nuk janë me interes publik: (2) Pse ish-ambasadori, mbartës i një funksioni publik të lartë në shtet të mos konsiderohet si burim relevant i informacioneve?⁷⁹

Nevojitet ndryshim urgjent i Ligjit për Shërbime Audio dhe Audiovizuale, me qëllim që të ndalohet reklamimi me pagesë nga shteti, si dhe të sigurohet pavarësi dhe destabilizim i trupit rregullator – Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale, nëpërmjet ndryshimit të zgjedhjes së anëtarëve.

Mediat duhet ta intensifikojnë informimin e opinionit për tema që janë me rëndësi të madhe shoqërore duke u mundësuar kështu qytetarëve qasje te një spektër më i madh i informacioneve të nevojshme që të mund të marrin pjesë në mënyrë efikase dhe efektive në proceset që ndikojnë mbi jetën dhe punën e tyre, në mënyrë të pavarur dhe pa vetëcenzurë.

Gazetarët t'i zbatojnë standardet themelore profesionale kur informojnë për tema me rëndësi të madhe shoqërore duke informuar saktë, në mënyrë të balancuar dhe të ndershme dhe të kenë kujdes për besueshmërinë, relevancën, besimin dhe kredibilitetin e teksteve të veta. Gazetarët ta praktikojnë, pronarët ta mbështesin dhe redaktorët ta nxitin gazetarinë hulumtuese për tema me interes të gjerë shoqëror si një mënyrë që mediat ta realizojnë rolin e vet shoqëror dhe të zmadhojnë besimin dhe kredibilitetin e opinionit, kurse kështu edhe të ardhurat personale.

⁷⁸ Nga monitorimi i aktiviteteve të Fondacionit NVO Infoqendër.

⁷⁹ Nga monitorimi i aktiviteteve të NVO Infoqendër.

Mediat të investojnë (mjete, kohë, teknikë dhe përpjekje) në edukim shtesë të gazetarëve dhe redaktorëve jo vetëm në respektimin e standardeve themelore profesionale por edhe për teknikat dhe metodat e gazetarisë hulumtuese. Mediat t'u mundësojnë gazetarëve të vet mbrojtje juridike dhe tjetër lloj mbrojtjeje për informim profesional dhe objektiv të opinionit, kurse gazetarët t'i shfrytëzojnë dispozitat ekzistuese ligjore në këtë drejtim.

Shoqatat dhe organizatat e gazetarëve duhet t'i intensivikojnë përpjekjet e veta që të sigurojnë kushte gazetarët dhe profesionalistët e tjerë të mediave t'i kryejnë obligimet e veta të punës në mënyrë profesionale dhe të lirë prej frikës dhe presionit.

Nevojitet ndryshim i Ligjit për Përgjegjësi Qytetare prej Ofendimit në aspektin e përkufizimeve (harmonizim me nenin 10 të GjEDNj-së), si edhe ndryshim i rregullave procedurale për përjashtim të rasteve me vlerë më të vogël dhe përdorim të mediacionit.

E drejta e arsimit

Në këtë pjesë është shumë shqetësuese kufizimi i të drejtës së arsimit të të miturve në shtëpitë përmirësuese ndëshkuese. Në Shtëpinë përmirësuese ndëshkuese Ohër, ku janë vendosur të mitur edhe nga shtëpia edukuese-përmirësuese Tetovë për shkak të rinovimit të institucionit, arsim formal nuk ekziston. Ekzistojnë aktivitete arsimore joformale, të cilat zhvillohen nëpërmjet projekteve me donacione të huaja ku fëmijët mësojnë maqedonisht, matematikë, njohje me mjedisin, muzikë, fizkulturë dhe arsim artistik. Këto lëndë mësohen në nivel fillor, duke pasur parasysh se përqindja më e madhe e fëmijëve janë me arsim të prapambetur, një përqindje e mirë e tyre janë analfabetë, kurse një pjesë e vogël kanë përfunduar arsimin tetëvjeçar dhe të mesëm (2 nga 11). Fëmijët nuk kanë në dispozicion një bibliotekë, përkatësisht literaturë për të lexuar në çdo kohë, që është një mungesë serioze.

Arsimi formal në institucionet edukuese dhe ndëshkuese për të mitur duhet të vendoset në një kohë sa më të shpejtë. Derisa të vendoset arsimi formal të zmadhohet fondi i orëve të fëmijëve, nëpërmjet futjes së lëndëve të reja shtesë (të drejtat e njeriut, shkathtësi jete) kështu që koha e fëmijëve do të jetë e mbushur dhe koha që do të kalojnë në orë do të jetë përafërsisht e njëjtë me atë që do ta kalonin sikur të ishin në liri.

E drejta e pronësisë

Është për t'u lavdëruar politika e legalizimit të objekteve të ndërtuara pa lejë që ka filluar të zbatohet në vitin 2011. Megjithatë, ky proces zhvillohet shumë ngadalë, kurse mbetet edhe shqetësimi se gjatë zbatimit të Ligjit për Veprim me Objektet e Ndërtuara pa Lejë qytetarët do të ballafaqohen me shumë çështje të pazgjidhura në lidhje me patundshmërinë ku gjendet objekti paletë, nga përfundimet e të cilave varet vijimi i procedurës. Popullata rome ballafaqohet sidomos me një sërë çështjesh të cilat ndikojnë në rregullimin e statusit në ndërtesat pa lejë ku jetojnë. Trualli ku është ndërtuar objekti shpesh nuk është përfshirë në plan ose pjesa ku ka popullatë rome është parashikuar për rrip të gjelbër dhe jo për strehim individual, që do të thotë se legalizimi i këtyre objekteve është në pikëpyetje dhe pritet vendim i këshillit të komunës se a do të përfshihen këto në dokumentacionin urbanistik të planit. Komunitat, përsëri, nuk i ndryshojnë planet e përgjithshme dhe të detajuara urbanistike për këto mjedise për shkak se kinse nuk kanë financa, kështu që preken pjesa më e madhe e kërkesave rome për legalizim. Mandej, zgjidhja e çështjeve të shumta paraprake për të cilat nuk ekziston sinkronizim me procedurën për legalizim çon në moszbatim të Ligjit. Për shkak të marrëdhënieve të parregulluara juridike-pronore komunitat nuk i kanë kryer ende tërësisht procedurat për legalizim të objektit vetëm me deklaratë të vërtetuar nga noteri se dorëzuesi e shfrytëzon tokën ndërtimore më tepër se 20 vjet.

Duhet të barazohet zbatimi i Ligjit për Veprim me Objektet e Ndërtuara pa Lejë dhe të zbatohen efektivisht politikat e ngjashme prej të cilave varet zbatimi i legalizimit. Agjencia për Kadastrëne Patundshmërisë duhet t'i përforcojë resurset në dispozicion për të dalë zyrtarisht në tokën ku ka objekte pa lejë. Komunitat duhet të përforcojnë përpjekjet e veta dhe të sigurojnë dokumentacionin urbanistik të planit për objektet e ndërtuara pa lejë në truall i cili është lënë në dokumentacionin urban të planit në fuqi për rrugë, rrip të gjelbër apo është jashtë spektrit të planit.

Barazia gjinore dhe të drejtat e grave⁸⁰

Ndryshimi dhe Plotësimi i Ligjit për Mundësi të Barabarta nënkupton se duhet të ketë model të standardizuar për informim mbi zbatimin e ligjeve nga pushtetet lokale dhe shtetërore. Megjithatë, shkalla e zbatimit nuk mund të vlerësohet, sepse raportet e pushtetit shtetëror dhe lokal mbi zbatimin e Ligjit për Mundësi të Barabarta nuk janë në dispozicion të publikut, nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Numër i kufizuar i komunave kanë politika për barazi gjinore, kurse informimi për zbatimin e legjislacionit për barazinë gjinore dhe politikat është shumë i kufizuar.

⁸⁰Në këtë pjesë janë përdorur të dhënat dhe konstatimet e Platformës për barazi gjinore: <http://rodovaplatforma.mk/>

Sektori për Mundësi të barabarta (SMB) në suazat e MPPS-së nuk ka resurse përkatëse (njerëzore, teknike dhe financiare) për përparim të barazisë gjinore. Nevojiten reforma institucionale me qëllim që të përforcohet pozita e SMB-së në suazat e makinerisë gjinore, si dhe të zmadhohen kompetencat e tij, që të mund ta plotësojë mandatin e tij. Mungesa e vullnetit politik rezulton me mungesë të resurseve financiare, njerëzore dhe teknike për zbatim të Strategjisë për Barazi Gjinore 2013-2020. Plani Nacional për Aksion përfundon në vitin 2016 dhe në këtë moment nuk ka informacione në dispozicion në lidhje me përgatitjen e një plani të ri për aksion.

Komisioni i Kuvendit për Mundësi të Barabarta nuk e shfrytëzon mundësinë për monitorim të zbatimit të Ligjit për Mundësi të Barabarta, kurse kështu nuk insistohet në zbatimin e tërësishëm të përfundimeve të nxjerra për harmonizim të raporteve për zbatimin e Strategjisë për Barazi Gjinore 2013-2020 me prioritetet sektoriale, masat, indikatorët, implikimet financiare. Gjithashtu, në vitin 2015 seanca e Komisionit për Përparim të Vendit në pjesën që lidhet me barazinë gjinore nuk ishte e hapur për publikun dhe përfaqësuesit e organizatave qytetare. Kjo praktikë duhet të ndryshojë dhe në vitin 2016 Komisioni duhet të organizojë debat publik dhe ta shqyrtojë Raportin e Përparimit në vitin 2016 nga perspektiva gjinore dhe të sigurojë pjesëmarrje të tërësishme të organizatave qytetare në këtë proces.

Pjesëmarrja e grave në tregun e punës mbetet në nivel shumë të ulët edhe përkrah faktit se numri i grave me arsim të lartë është më i madh në krahasim me burrat. Të drejtat e grave punëtore vazhdojnë të mbrohen në mënyrë jo si duhet, sidomos në industrinë e tekstitit, ku 82% e të punësuarve janë gra, kurse vetëm 9% janë anëtarë të sindikatës. Ligji për Rrogë Minimale i miratuar në vitin 2012 nuk e përfshin prodhimtarinë, industrinë e tekstitit dhe të lëkurës, ku pjesa më e madhe e të punësuarve janë gra. Këto industri kanë afat përshtatjeje prej tri vjetësh (2012-2014), por në vitin 2014 janë dhënë edhe 4 vjet shtesë për përshtatje. Përkrah thirrjeve të shumta nga shoqëria qytetare, nuk ka diskutime për ndryshim të këtij vendimi.

Kërkesa e obliguar me shkrim për ndalim të shtatzënisë së padëshiruar nga gruaja në institucionin përkatës shëndetësor, këshillimi i obliguar joobjektiv dhe periudha e obliguar për të pritur prej tri ditësh (pas këshillimit) para intervenimit mjekësor i pengon gratë që të realizojnë të drejtën e tyre të abortit të sigurt. Këshillimi i obligueshëm është rregulluar me Rregullore, por ajo zbatohet joobjektivisht, me qëllim që gratë të binden të mos e ndërpresin shtatzëninë.

Numri i pamjaftueshëm i gjinekologëve dhe shërbimeve gjinekologjike në shtet, sidomos në mjediset rurale, i pengon gratë në qasje të shërbimeve shëndetësore. Kjo rezulton me zmadhimin e foshnjave dhe normën e vdekshmërisë të nënat (norma e vdekshmërisë perinatale shtë 14,3% në krahasim me atë të BE-së prej 5,2%). Mjetet financiare për foshnjat dhe për shëndetin e nënave zvogëlohen vazhdimisht dhe të njëjtat rregullisht jepen për qëllime të tjera, kurse procesi i informimit nuk është transparent. Në nëntor të vitit 2015 Ministria e Shëndetësisë paralajmëroi masa të reja të cilat duhet të sigurojnë se gratë shtatzëna do të kenë shërbime gjinekologjike falas gjatë shtatzënisë. Edhe pse nuk mund të jepet ende vlerësim për efektet e kësaj mase, raportet fillestare dëshmojnë zbatim selektiv

dhe përfshirje të kufizuar. Fondi i Sigurimit Shëndetësor nuk i mbulon metodat bashkëkohore të kontracepsionit, që i mbingarkojnë gratë në mbrojtjen e shëndetit reproduktiv dhe planifikimin e familjes.

Vazhdon mbrojtja joefikase e grave nga format familjare e të tjera të dhunës të bazuara në gjini. Gjatë vitit 2015 janë regjistruar edhe 5 raste të femicidit – përkatësisht të vrasjevetë grave nga partnerët intimë të tanishëm apo të mëparshëm. Një prej vrasjeve më brutale ndodhi në muajin tetor 2015 kur gruaja është vrarë me sëpatë nga bashkëshorti i saj. Në buletin e ngjarjeve ditore, Ministria e Punëve të Brendshme si shkak për vrasje i ka vendosur marrëdhëniet e shkatërruara familjare, kurse jozyrtarisht, para ngjarjes ka pasur grindje. Vetëm pas dy ditësh, në media doli ngjarja në Koçani, ku një burrë u vetëvra me varje, pasi mbrëmjen e mëparshme e ka keqtrajtuar fizikisht bashkëshorten e vet dhe e ka goditur me thikë në dorë.

Këto dy ngjarje janë vetëm vazhdim i ngjarjeve të shumta të dhunës së bazuar në gjini dhe dhunës familjare që kanë përfunduar me raste vdekjeje në dy vitet e kaluara. Në muajin maj 2015, një grua më në moshë është gjetur e vdekur në shtëpinë e saj në lagjen e Shkupit, Përzhino, me gjurmë të dukshme të dhunës, kurse si i dyshuari i parë ishte djali i saj. Në janar, një grua shtatzënë është vrarë në Spitalin e Fëmijëve në Shkup, kurse pastaj është hedhur nga çatia prej kryerësit të vrasjes.

Gjendja e tillë është shqetësuese sidomos nëse merret parasysh se shteti nuk siguron mbrojtje të veçantë për të gjitha format e dhunës të bazuar në gjini, e as nuk mban evidencë për rastet e femicidit. Prandaj, mund të konstatohet se shteti nuk i ka përmbytur ende standardet minimale të cilat duhet të garantojnë mbrojtje efikase të grave prej dhunës. Mungesa e reagimit përkatës nga policia dhe qendrat për mbrojtje sociale, numri i vogël i qendrave shelter për viktime dhunës familjare, mungesa e linjës shumëgjuhësore nacionale SOS, janë vetëm një pjesë e problemeve sistematike për shkak të të cilave mund të konstatohet se shteti nuk i plotëson kushtet për sigurim të mbrojtjes së drejtë të grave viktime të dhunës së bazuar në gjini. Në raport me mbrojtjen nga dhuna gjinore, është e rëndësishme të përmendet se Maqedonia nuk e ka ratifikuar Konventën e Stambollit dhe as nuk është përkufizuar dhe rregulluar dhuna në bazë gjinore. Këto kushte janë përcaktuar në Konventën e Stambollit, e cila është dokumenti i parë gjithëpërfshirës për mbrojtje të grave nga dhuna, që Republika e Maqedonisë e ka nënshkruar, por ende nuk e ka ratifikuar.

Në fund të vitit 2016 duhet të përgatitet evalvim i pavarur i zbatimit të Planit aksionar në vijim që të identifikohen sfidat dhe dobësitë në zbatimin e tij që të vendosen si duhet në Planin e ri aksionar. Në përgatitjen e planit të ri aksionar duhet të sigurohet pjesëmarrje e tërësishme e organizatave qytetare.

Nevojiten ndryshime të rrënjësishme në kornizën ligjore për mbrojtjen e viktimeve, përmirësim i kushteve në qendrat strehuese, si dhe të përmirësohet profesionalizmi dhe reagimi përkatës i nëpunësve policorë, qendrave për punë sociale dhe gjykatave të cilat duhet t'i mbrojnë viktimat.

■ E drejta prodedurale

Liria dhe siguria

Në shkurt 2016, Prokuroria Publike Speciale ka hapur procedurë hetuese dhe propozoi masë paraburgim kundër shumë personave (midis të cilëve edhe ish ministra për punë të brendshme dhe transport dhe lidhje, anëtarë të Komisionit Shtetëror Zgjedhor dhe gjykatës në Këshillin Administrativ) për vepra penale kundër zgjedhjeve dhe votimit që dalin nga materialet joligjore të përgjuara. Të gjitha propozimet janë refuzuar nga Gjykata Themelore Shkup 1.⁸¹ Refuzimi i përcaktimit të masës paraburgim nga Gjykata është precedent, sepse në tri vitet e kaluara gjykata në asnjë rast të krimit të organizuar nuk e ka refuzuar masën paraburgim të propozuar nga Prokuroria Publike për ndjekje të krimit dhe korrupsionit të organizuar.⁸²

Përkundrajt vendimeve për lëndët të cilat i ngriti Prokuroria Publike Speciale, Gjykata përcaktoi masën paraburgim shtëpiak për katër pjesëmarrës në protestat kundër vendimit për abolicion të Presidentit të Republikës së Maqedonisë (Shiko: Lira e Tubimit dhe Shoqërimin).

Praktika e tillë jokonzistente e gjykatave në raport me paraburgimin flet qartë për selektimin në drejtësi dhe faktikisht ndikimin serioz të pushtetit mbi gjyqësorin.

Është i domosdoshëm ndryshimi i praktikës gjyqësore dhe të prokurorisë publike në raport me paraburgimin për zbatim konsistent të Ligjit për Procedurë Penale.

⁸¹Shpallje të Gjykatës Themelore Shkup 1 në lidhje me kërkesat dhe vendimet për përcaktim të masës nëpërmjet: <http://www.osskopje1.mk/Novosti.aspx>

⁸²Raporte vjetore për punësim në prokuroritë publike në Republikën e Maqedonisë për vitin 2012, 2013 dhe 2014: http://jorm.gov.mk/?page_id=31

■ Mbrojtja e pakicave dhe të drejtave kulturore

Gjatë 15 viteve të fundit Marrëveshja Kornizë e Ohrit (MKO) e ka dëshmuar potencialin e vet si kornizë për sigurim të demokracisë multietnike funksionale. Megjithatë, thellimi i kuptimit të ndërsjellë midis bashkësive të ndryshme dhe ndërtimit një shoqërie kohezive mbetet sfida e qëndrueshme.

Me kalimin e kohës ka⁸³ përmirësim të theksuar, por kohët fundit është zvogëluar, të përfaqësimit të drejtë. Në hulumtimin e kryer nga EPI⁸⁴, rezultatet dëshmojnë se perceptimi për grupet etnike të cilat janë në pozitën më të keqe në aspektin e përfaqësimit të drejtë në institucione në vend të parë janë romët (37,6%), megjithatë, mandej vijnë shqiptarët (19,3%). Përfaqësimi i drejtë dhe përkatës gjithnjë edhe më tepër konsiderohet si proces i monopolizuar i cili lidhet vetëm me bashkësinë shqiptare, duke i marginalizuar bashkësitë me numër më të vogël. Edhe përkrah përfitimeve të vëna re prej zbatimit të përfaqësimit të drejtë, janë identifikuar edhe pengesa serioze. Këto pengesa së pari lidhen me politizimin e administratës, përkushtimin e udhëheqësve, punësimin problematik dhe procedurat për punësim së bashku me mekanizmat joadekuatë për monitorim dhe sanksionim dhe mungesa e kushteve themelore të punës dhe kufizimet në buxhet.

Mendimi dominues është se zbatimi i parimit në masë të madhe varet nga përkatësia etnike e institucionit. Dhe në nivel qendror dhe në nivel lokal, zbatimi i parimit nuk është vendosur në pikëpyetje në institucionet e menaxhuara nga Shqiptarët. Edhe më tepër, në këto institucione është arritur nivel i kënaqshëm i përfaqësimit. Megjithatë, shihet nevoja e plotësisht të nivelit të përcaktuar ligjor për përfaqësimin e drejtë në institucionet e menaxhuara nga personat me përkatësi etnike maqedonase.

Se kartela partiake është para meritave, është mendimi edhe të të punësuarve në administratë. Ata konsiderojnë se nevojitet departizim i institucioneve. Punësimet partiake shfaqen si problemi më i madh dhe ekziston trend i punësimit pa vlerësim paraprak të nevojës për punësim dhe të profilit të të punësuarve. Theksohet nevoja për zbatim të tërësishëm të sistemit të meritave duke i ruajtur parimet e kompetencës dhe integritetit. Në atë drejtim është e nevojshme gjetja e mekanizmave për tejkalimin manipulimeve politike të ligjeve, sidomos në pjesën që lidhet me procedurën për punësim, si dhe zbatimin konsistent të Metodologjisë për përfaqësim përkatës dhe të drejtë.

Gjithashtu, hulumtimi dëshmon se ekziston një segregacion i caktuar i vendeve të punës në kuptimin se sektorët dhe njësitë në suazat e administratës shtetërore janë etnikisht të shumëllojshme, por shumëllojshmëria shprehet kryesisht nëpërmjet numrave në numrin e përgjithshëm të sektorëve dhe njësive. Megjithatë jo të gjitha njësitë, sektorët dhe ekipet, madje edhe institucionet, kanë përbërje të përzierë etnike.

⁸³Raportet e Avokatit të Popullit, Sekretariatit për Zbatim të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë

⁸⁴Ristevska Jordanova M., Ardita Abazi Imeri, et al "Jetë dhe numra - përfaqësimi përkatës dhe i drejtë dhe integrimi në vendin e punës", Instituti për Politikë Evropiane, mars 2016, Shkup http://epi.org.mk/docs/Life%20and%20Numbers_MK_Final%20version.pdf

Parimi i përfaqësimit të drejtë dhe përkatës lidhet me të gjithë sektorin publik në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe ndërmarrjet publike, të cilat dëshmojnë një përfaqësim drastik të pamjaftueshëm të bashkësive.⁸⁵ Megjithatë, nuk ka të dhënë në dispozicion për përfaqësimin e drejtë në ndërmarrjet e tilla.⁸⁶ Pasqyrimi i MKO-së për kohezionin social e njihet nevojën për zgjerim të zbatimit të përfaqësimit të drejtë në ish-ndërmarrjet publike të privatizuara apo kompanitë e mëdha me rëndësi nacionale, duke marrë parasysh se ky parim është vlera themelore e rendit kushtetues.⁸⁷

Procesi i punësimit deri tani i ka lënë anësh meritat e fuqisë punëtore shumëgjuhësore dhe të fitimeve nga një administratë e përbërë nga nëpunës administrativë e cila mund të komunikojë drejtpërdrejt me qytetarët në gjuhët zyrtare. Personeli shumëgjuhësor potencialisht do të kishte ndikim pozitiv mbi integrimin e fuqisë së punës dhe mbi efikasitetin e administratës në shërbim të qytetarëve të Maqedonisë. Pasqyrimi i MKO-së për kohezionin social konstaton se në procesin për përzgjedhje dhe përparim, njohjes së një gjuhe tjetër zyrtare në Maqedoni, i është dhënë më pak rëndësi në raport me njohjen e gjuhës së huaj dhe kështu lihet pas dore një mundësi e rëndësishme që të promovohet dhe të vlerësohet shumëllojshmëria gjuhësore në Republikën e Maqedonisë.⁸⁸ Mësimi i gjuhës së bashkësive të tjera etnike nga të punësuarit në administratë shihet si aktivitet i cili duhet të kontribuojë për një integrim më të madh.⁸⁹ Rezultatet dëshmojnë se numri më i madh të të punësuarve do të kishin shkuar në kurs për mësimin e gjuhëve të grupeve të tjera etnike.⁹⁰ Gjithashtu, perceptimet për një integrim më të madh janë se kjo gjë mund të arrihet nëpërmjet arsimit.

CNDARJA në sistemin arsimor vite me radhë është mbështetur në mënyrë të hapur ose lantente, me qëllim që të anashkalohen situatat e konfliktit midis nxënësve të grupeve të ndryshme etnike. Megjithatë, kjo ndarje si pasojë kishte përforsimin e stereotipave dhe të paragjyqimeve ndaj tjetrit të dy grupet më të mëdha etnike. Pothuajse një dekadë pas miratimit të MKO-së, u shfaq pranimi për rënie në sistemin arsimor në aspektin e zhvillimit të kohezionit shoqëror midis grupeve kulturore të ndryshme.⁹¹

Kur bëhet fjalë për masat dhe për aktivitetet të cilat lidhen me promovimin e arsimit të integruar në Republikën e Maqedonisë, pavarësisht nga Strategjia e miratuar nga ministria kompetente, është e nevojshme të thuhet se pjesa më e madhe iniciativave në aspektin e këtij problemi dalin nga aktivitetet e organizatave ndërkombëtare, kurse përkushtimi i institucioneve të sistemit është i vogël.⁹²

⁸⁵ http://www.siofa.gov.mk/Pasqyrë_e_MKO-së_për_kohezionin_social_f.27

⁸⁶ Nga fundi i vitit 2015 është përgatitur Pasqyra e zbatimit të marrëveshjes Kornizë të Ohrit në kontekst të kohezionit social. Ky dokument është mbështetur nëpërmjet Misionit të OSBE-së në shtet dhe Institutit Evropian për Paqe, kurse e ka përgatitur Sekretariati për Zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Raporti nuk është shpallur para publikut të Maqedonisë, por Instituti Evropian për Paqe në faqen e vet të internetit e ka shpallur në mënyrë të integruar analizën e tërësishtme: <http://eip.org/sites/default/files/OFA%20Review%20on%20Social%20Cohesion.pdf>. Edhe pse ish-zëvendëskryeminsitri Musa Xhaferi ka informuar se përfundimet e pasqyritit do të diskutohen në konferencë ndërkombëtare, kjo gjë nuk ndodhi. Në reagimin e vet VMRO-DPMNE kundërshtoi se Qeveria është porositëse e analizës, duke kundërshtuar shqyrtimin e mëtejshëm të rezultateve me çka u ndërpre edhe procedura qeveritare për shqyrtimin e dokumentit.

⁸⁷ <http://eip.org/sites/default/files/OFA%20Review%20on%20Social%20Cohesion.pdf>.

⁸⁸ http://www.siofa.gov.mk/Pasqyrë_e_MKO-së_për_kohezionin_social_naORDza социјална кохезија

⁸⁹ Ristevska Jordanova M., Ardita Abazi Imeri, et al "Jetë dhe numra – përfaqësimi përkatës dhe i drejtë dhe integrimi në vendin e punës", Instituti për Politikë Evropiane, mars 2016, Shkup http://epi.org.mk/docs/Life%20and%20Numbers_MK_Final%20version.pdf

⁹⁰ 76% e të anketuarve kanë vajtur në kurs për mësimin e gjuhës së grupeve të tjera etnike, krahasuar me 14,8% të cilët nuk do ta shfrytëzonin këtë mundësi

⁹¹ B. Bakiu, M. Dimitrovska, A. Brava. Si të arrihet arsimit i integruar në Republikën e Maqedonisë?, Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, Shkup, 2016 http://epi.org.mk/docs/D4V_Social%20cohesion_mk.pdf

⁹² Ibid.

Nevojitet diskutim gjithëpërfshirës për Pasqyrimin e realizimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe rekomandimet e saj, me qëllim që në nivel politik të arrihet pajtueshmëri për ndërtimin e shoqërisë kohezive.

Nevojiten masa për arritjen e nivelit ligjor të paraparë të përfaqësimit në të gjitha institucionet dhe në të gjitha nivelet duke përfshirë edhe pozitave udhëheqëse në institucione. Nevojitet të përshpejtohet tempoja dhe të zmadhohet përfaqësimi i bashkësive në numër më të vogël në administratën publike në nivel lokal dhe qendror. Përkrah kësaj, duhet të vendoset mekanizëm gjithëpërfshirës për ndjekjen dhe zbatimin e Metodologjisë për planifikim të fuqisë së punës, si dhe masës për sanksionin për zbatimin e saj përkatës. Duhet të vendoset edhe sistemi për ndjekjen e zbatimit të politikave gjuhësore në nivel qendror dhe lokal me qëllim që të përcaktohen dhe të adresohen përkatësisht mangësitë e tyre.

■ Masa kundër racizmit dhe ksenofobisë

Në periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2015, Komiteti i Helsinkit ka regjistruar 44 vepra të kryera nga urrejtja. Verifikimi dhe joverifikimi i incidenteve gjenden në portalin – www.zlostorstvodomraza.mk. Krahasuar me incidentet e regjistruara na vitin 2013 dhe 2014, dallimi më i madh lidhet me viktimat, shumica e të cilave janë të ikur. 21 prej 44 incidenteve (48%) në vitin 2015 lidhen me vjedhjet ndaj migrantëve gjatë tranzitimit të tyre nëpër shtet. Gjatë këtyre incidenteve, minimum 58 nga viktimat (46% prej gjithë viktimave të regjistruara) ishin shtetas të Sirisë, Afganistanit dhe Marokut. Një dallim tjetër i madh, por pozitiv është numri i incidenteve për shkak të përkatësisë etnike maqedonase apo shqiptare. Në vitin 2013 këto incidente këto incidente përbënin 84% të të gjitha incidenteve (98 prej 116), kurse në vitin 2014 ai numër ishte 61% (53 prej 87). Gjatë vitit 2015 janë regjistruar vetëm 15 incidente (34%) midis maqedonasve dhe shqiptarëve.

Shumica e veprave nga urrejtja janë kryer nga hajdutë dhe të rinj. Veprat më të shpeshta penale janë Grabitje (23), Dhunë (21), Lëndim trupor (17) dhe Shkatërrim i pronës (6). Numri më i madh i incidenteve kanë ndodhur në Shkup (18) dhe rrethinën e tij. Dhjetë (10) incidente ka pasur në Gjevgjeli dhe 6 në Kumanovë. Veprat nga urrejtja kundër migrantëve zakonisht ndodhin përgjatë autostradës që është pjesë e Korridorit Panevropian 10. Janë regjistruar 125 viktima dhe 174 kryerës të veprave nga urrejtja. Shumica e viktimave janë migrantë dhe të rinj me përkatësi etnike maqedonase ose shqiptare. Në 33 incidente prej 44 gjithsej kryerësit kanë vepruar në grup. Nga përgjigjet e marra me shkrim nga MPB-ja, policia i ka zbuluar kryerësit të 20 incidenteve minimum. Për incidentet e tjera policia është informuar dhe ato janë në hetim.

Nga fundi i vitit 2015, grupi i punës i formuar nga anëtarët e shteteve, institucionet dhe organizatat akademike dhe joqeveritare ka përgatitur propozim-ndryshime të Kodit Penal me qëllim që të përcaktohen veprat e urrejtjes dhe të ashpërsohet politika ndëshkuese ndaj kryerësve të këtyre veprave. Propozim-ndryshimet janë dorëzuar në Ministrinë e Drejtësisë,

por nuk janë propozuar për miratim në Kuvendin e RM-së. Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë e ka zmadhuar numrin e trajnimeve në këtë fushë, por në vitin 2015, në nivel nacional është mbajtur një gjykim për vepër nga urrejtja në Gjykatën Themelore Strugë.⁹³

Gjatë vitit 2015 në platformën e Komitetit të Helsinkit –www.govornaomraza.mk janë paraqitur 33 raste të fjalës së urrejtjes, prej të cilave 26 ishin verifikuar. Si bazat më të përfaqësuara për rastet e paraqitura të fjalës së urrejtjes janë orientimi seksual dhe identiteti gjinor, përkatësia etnike dhe fetare dhe përkatësia politike. Fjala e urrejtjes është më e pranishme në rrjetet sociale, por nuk mbeten pas edhe portalet e internetit përkatësisht mediat e bazuara në internet. Shqetëson fakti se fjala e urrejtjes është gjithnjë dhe më e pranishme në kolumnat dhe tekstat e mediave në internet me çka shkatërrohen standardet etnike dhe parimet e gazetarisë, për këtë flasin edhe vendimet e shumta të Këshillit për Etikë në media.⁹⁴

Edhe përkrah zmadhimit të pranishmërisë së fjalës së urrejtjes në jetën publike dhe në jetën e përditshme, vërehet një numër relativisht i vogël i ngjarjeve për përdorim të fjalës së urrejtjeve. Mosparaqitja e rasteve mund të shpjegohet si pasojë e dy faktorëve. Faktori i parë është mosdallimi i fjalës së urrejtës dhe elementët e tij themelorë, si dhe moskufizimi i tërësishëm i themeleve për fjalën e urrejtjes nga qytetarët. Paralelisht me këtë jepet dhe mosdija e qytetarëve mbi kompetencat e institucioneve dhe obligimet për veprim në rastet e fjalës së urrejtjes. Faktori i dytë, shumë më i rëndësishëm është numri i vogël i rasteve të akuzave të ngritura për fjalët e urrejtjes nga prokuroria publike është i ulët, pothuajse një numër joekzistues i personave të gjykuar dhe të dënuar të cilët kanë përdorur fjalën e urrejtjes. Domethënë, gjatë vitit 2015, para 21 gjykatave prej të cilave Komiteti i Helsinkit ka marrë përgjigje, është mbajtur vetëm një procedurë penale në Gjykatën Themelore Shkup 1, për vepër sipas nenit 417 të Kodit Penal (Diskriminim rasor dhe tjetër) ku ka elementë të fjalës së urrejtjes.⁹⁵

Prokuroria Publike dhe gjykatat të tregojnë zero tolerancë për veprat dhe fjalët nga urrejtja dhe t'i ndjekin dhe gjykojnë si duhet rastet e tilla në suazat e kompetencave të veta. personat publikë dhe përfaqësuesit e lartë politikë është e domosdoshme të përmbahen nga përdorimi i fjalës së urrejtjes dhe ta gjykojnë përdorimin e saj. Është e obligueshme të respektohen standardet etnike dhe profesionale në gazetari, që do ta bëjnë të pamundur përdorimin e gjuhës së urrejtjes në media.

⁹³ K.nr. 227/14.

⁹⁴ Vendime dhe mendime të Komisionit për Ankesa të Këshillit për Etikë në Mediat e Maqedonisë <http://semm.mk/komisija-za-albi/odluki-i-mislenja>

⁹⁵ Komiteti i Helsinkit ka dërguar Kërkesë për qasje të informacionet me karakter publik të të gjithë 27 gjykatat në Republikën e Maqedonisë, kurse ka marrë përgjigje vetëm prej 21 gjykatash.

■ Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Gjatë vitit 2015, Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (DDhP) ka marrë 393 fletëparaqitje gjithsej, ka kryer 394 mbikëqyrje inspektuese. Kjo e dhënë dëshmon ulje të numrit të mbikëqyrjeve inspektuese të kryera në krahasim me vitin e kaluar me 10 mbikëqyrje. Në lidhje me pyetjen në a raste DDhP-ja ka kryer mbikëqyrje me iniciativën e vet, morëm përgjigje se për këtë bëhen plane të veçanta dhe mbikëqyrje kryhen sipas fushave.

Megjithatë DDhP-ja vendosi të kryejë mbikëqyrje inspektuese të papritur me iniciativën e vet në Komisionin Shtetëror Zgjedhor (KShZ) për shkak të shpalljes së të dhënave të Listës Zgjedhore në ueb-faqen e KShZ-së. Në këtë rast Drejtoria ka marrë vendim me të cilin iu drejtuar KShZ-së “të sigurojë qasje elektronike të të dhënave personale në Listë Zgjedhore të shpallur në ueb-faqen <https://izbirackispisok.gov.mk>” Drejtoria u mbështet në faktin se në përputhje me Kodin Zgjedhor (neni 55 paragrafi 1) parashikohet se të dhënave personale që Listës Zgjedhore mbrohen në përputhje me ligjet dhe nuk mund të përdoren për asnjë qëllim tjetër, përveç se realizimit të të drejtës së votës së qytetarëve. Në një vendim tjetër të përkohshëm, Drejtoria e ka ndaluar KShZ-në të shpallë të dhënave personale për personat fizikë, duke vlerësuar se “KShZ-ja nuk ka bazë ligjore të kryejë përpunim nëpërmjet shpalljes së të dhënave personale të personave fizikë...” Të dy zgjidhjet ishin shpallur si rezultat i kryqëzimit të data-bazave me Listën Zgjedhore dhe dyshimin për një numër të madh të të a.q. votuesve fantomë. KShZ-ja në seancë të hapur vendosi të veprojë sipas vendimeve të drejtorisë, por, njëkohësisht paralajmëroi se do të ankohet te Gjykata Administruese e RM-së.

Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të përfshihet më aktivisht në mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale të qytetarëve.

Bibliografi:

Instituti për Politikë Evropiane, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Instituti për Drejtat e Njeriut, Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë" dhe NVO Infoqendra, 2106. Prioritetet Reformuese Urgjente më të ngadalshme se restaurimi i praktikave joreformuese!. Shkup: Instituti për Politikë Evropiane. Gjendet në: <http://epi.org.mk/docs/URP%20alb.pdf>

Instituti për Politikë Evropiane, 2016. Statusi i realizimit të Prioriteteve Reformuese urgjente. Shkup: Maqedonia – BE Qendra e Resurseve (MEQR). Gjendet në: <http://www.merc.org.mk/status-na-realizacija-na-itni-reformski-prioriteti>[18.05.2016]

Ristevska Jordanova M., Abazi-Imeri A., Kotevska B. dhe Ançevska E., 2016. Jetë dhe numra – përfaqësimi përkatës dhe i drejtë dhe integrimi në vendin e punës. Shkup, Instituti për Politikë Evropiane. Gjendet në: http://epi.org.mk/docs/Life%20and%20Numbers_ALB_Final%20version.pdf

Instituti për të Drejtat e Njeriut, 2016. Sugjerime për Propozim-Strategjinë për Reforma në Sistemin Gjyqësor. Shkup: Instituti për të Drejtat e Njeriut. Gjendet në: [http://www.ihr.org.mk/imaqes/izvestai/novosti/sugestii%20na%20strategjijata%20 ichp_finaln i.pdf \[11.04.2016\]](http://www.ihr.org.mk/imaqes/izvestai/novosti/sugestii%20na%20strategjijata%20 ichp_finaln i.pdf [11.04.2016])

Rrjeti 23, 2016. Brif-Monitorimi për muajin prill 2016 nga ndjekja e Kapitullit 23 – gjyqësori, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore. Shkup. Rrjeti 23, Gjendet në: http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/04641/mk/Monitoring-brief_april-2016_MK_corr.pdf

Rrjeti 23, 2016. Brif-Monitorimi për muajin mars 2016 nga ndjekja e Kapitullit 23 – gjyqësori, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore. Shkup. Rrjeti 23, Gjendet në: http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/04626/mk/Monitoring-izveshtaj-za-sledenjeto-na-Poglavjeto-23-vo-mesec-mart-2016_Mreza-23-.pdf

Rrjeti 23, 2016. Brif-Monitorimi për muajin shkurt 2016 nga ndjekja e Kapitullit 23 – gjyqësori, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore. Shkup. Rrjeti 23, Gjendet në: http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/04592/mk/Monitoring-brief_fevruari-2016_mk.pdf

Rrjeti 23, 2015. Brif-Monitorimi për zbatimin e Prioriteteve Reformuese Urgjente për periudhën 15-30.12.2015. Shkup: Instituti për Politikë Evropiane (IPE), Gjendet në: http://www.epi.org.mk/docs/Mrezha-23_monitoring-izveshtaj-15-30%2012%202015.pdf

Rrjeti 23, 2015. Brif-Monitorimi për zbatimin e Prioriteteve Reformuese Urgjente për periudhën 20.11-15.12.2015.r.Shkup: Instituti për Politikë Evropiane (IPE), Gjendet në: http://www.epi.org.mk/docs/Mrezha-23_monitoring-izveshtaj-20.11-15.12.2015.pdf

Rrjeti 23, 2015. Brif-Monitorimi për zbatimin e Prioriteteve Reformuese Urgjente për periudhën 09-20.11.2015.Shkup: Instituti për Politikë Evropiane (IPE), Gjendet në: http://www.epi.org.mk/docs/Mrezha-23_monitoring-izveshtaj-9.11-20.11.2015.pdf

Rrjeti 23, 2015. Brif-Monitorimi për zbatimin e Prioriteteve Reformuese Urgjente për periudhën 21.10-06.11.2015. Shkup: Instituti për Politikë Evropiane (IPE), Gjetet në: http://www.epi.org.mk/docs/Mrezha23_monitoring-izveshtaj-21.10-06.11.2015.pdf

Rrjeti 23, 2015. Brif-Monitorimi për zbatimin e Prioriteteve Reformuese Urgjente për periudhën 1-20.10.2015. Shkup: Instituti për Politikë Evropiane (IPE), Gjetet në: http://www.epi.org.mk/docs/Mrezha%2023_monitoring%20izveshtaj%20 mk.pdf

Rrjeti 23, 2015. Brif-Monitorimi për zbatimin e Prioriteteve Reformuese Urgjente për periudhën 15.09-30.09.2015. Shkup: Instituti për Politikë Evropiane (IPE), Gjetet në: http://www.epi.org.mk/docs/Mrezha%2023_monitoring%20izveshtaj%20 IRP_15_9-1_10_15_mk.pdf

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM, 2014. Raporti mujor mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë qershor 2014. Shkup: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM
Gjetet në: <http://www.mhc.org.mk/reports/237>

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM, 2014. Raporti dymujor mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë për periudhën prill-maj 2014. Shkup: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM
Gjetet në: <http://www.mhc.org.mk/reports/219>

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM, 2013. Raporti dymujor mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë për periudhën korrik-gusht 2013. Shkup: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM
Gjetet në: <http://www.mhc.org.mk/reports/149>

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM, 2013. Raporti tremujor mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë për periudhën prill-qershor 2013. Shkup: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM
Gjetet në: <http://www.mhc.org.mk/reports/145>

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM, 2013. Raporti mujor mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë për marsin 2013. Shkup: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM
Gjetet në: <http://www.mhc.org.mk/reports/124>

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM, 2012. Raporti tremujor mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë për periudhën tetor-dhjetor 2012. Shkup: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM
Gjetet në: <http://www.mhc.org.mk/reports/99>

Talevski D., Kmeziq M., dhe Polozhani L., 2016. Përmirësimi i sistemit të pengesave dhe kontrolleve në Republikën e Maqedonisë: Kontrolli gjyqësor i pushtetit ekzekutiv. Shkup: Instituti për Politikë Evropiane (IPE) Gjetet në: http://www.epi.org.mk/docs/D4V_Democracy%20and%20Rule%20of%20Law_mk.pdf

Bakiu B., Dimitrovska M., dhe Brava A., 2016. Si të arrihet arsimi i integruar në Republikën e Maqedonisë?. Shkup: Instituti për Politikë Evropiane
Bogdanovska A. dhe Petrovska N., 2016 Këshilli Penal versus Ligjit për Procedurë Penale. Shkup: Koalicioni “Të gjithë për gjykim të Drejtë”. Gjendet në: http://www.all4fairtrials.org.mk/Main_files/KS%20versus%20ZKP.pdf [11.04.2016]

MODEM (Monitorimi i Demokracisë në Maqedoni), 2016. Raporti mbi ndjekjen e përbajtjeve të mediave nëpërmjet Mekanizmit për Mbikëqyrje dhe reagim në Institutin për Studime të Komunikimeve (periudha: 6 shkurt – 4 mars 2016). Shkup: Instituti për Studime të Komunikimeve. Gjendet në: http://respublica.edu.mk/modem/06-04-mart-2016/Third-Monthly-report-MODEM_opt.pdf

MODEM (Monitorimi i Demokracisë në Maqedoni), 2016. Raporti mbi ndjekjen e përbajtjeve të mediave nëpërmjet Mekanizmit për Mbikëqyrje dhe reagim në Institutin për Studime të Komunikimeve (periudha: 19 dhjetor 2015 - 29 janar 2016). Shkup: Instituti për Studime të Komunikimeve. Gjendet në: http://respublica.edu.mk/modem/19-29-januari/Second-Monthly-report-MODEM_mk_opt.pdf

MODEM (Monitorimi i Demokracisë në Maqedoni), 2015. Raporti mbi ndjekjen e përbajtjeve të mediave nëpërmjet Mekanizmit për Mbikëqyrje dhe reagim në Institutin për Studime të Komunikimeve (periudha: 23 nëntor - 18 dhjetor 2015). Shkup: Instituti për Studime të Komunikimeve. Gjendet në: <http://respublica.edu.mk/modem/MODEM-eden%2018%20noemvri%2023%20dekemvri.pdf>

NVO Infoqendra, 2015. Raporti: Politikanët dhe rastet gjyqësore për ofendim dhe shpifje. Shkup: NVO Infoqendra. Gjendet në: <http://nvoinfoqendar.mk/wp-content/uploads/2016/01/Politicarite-i-sudskite-slucai-za-navreda-i-kleveta1.pdf>

Andonovski K., Bogoevski P., Gelevska A., Bojanovska D., 2016. Analiza e problemeve dhe nevojave të njerëzve LGBTI në Republikën e Maqedonisë në fushën e mbrojtjes sociale, shërbimeve juridike dhe veprimt policor. Shkup: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë – LGBT Qendra për Mbështetje. Gjendet në: <http://lgbti.mk/uploads/3b7076e5-dc63-4b58-8bb6-ae2a46d91bc4.pdf>

Komisioni Evropian. Republika e Maqedonisë: Rekomandime të grupit të ekspertëve të lartë mbi problemet e sistemit në fushën e mbizotërimit të të drejtës lidhur me përgjimin e komunikimeve, shpallur pranverën e vitit 2015. Gjendet në: http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf

Komisioni Evropian. Prioritetet Reformuese Urgjente për Republikën e Maqedonisë (qershor 2015). Gjendet në: http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150619_urgent_reform_priorities.pdf

Komisioni Evropian për Demokraci nëpërmjet të Drejtës (Komisioni i Venecias). Mendimi i Ligjit për Mbrojtje të Privatësisë dhe Ligjit për Mbrojtje të Dëshmitarëve në Republikën e Maqedonisë, i miratuar në seancën e 106 plenare (Venecia, 11-12 mars 2016). Gjendet në: [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2016\)008-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)008-e)

Komisioni Evropian për Demokraci nëpërmjet të Drejtës (Komisioni i Venecias). Mendimi mbi Ligjin për Përgjegjësi Disiplinore dhe Evalvim të Gjykatësve në Republikën e Maqedonisë, miratuar në seancën plenare 105 (Venecia, 18-19 dhjetor 2015). Gjetet në:

[http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2015\)042-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2015)042-e)

Instituti Evropian për Paqe, 2015. Revizioni i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit në raport me kohezionin social. Shkup: Instituti Evropian për Paqe. Gjetet në:

<http://eip.org/sites/default/files/OFA%20Review%20on%20Social%20Cohesion.pdf>

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, 2015. Drift-plani mbi aktivitetet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përparitur në bazë të listës së Prioriteteve Reformuese Urgjente për Republikën e Maqedonisë - PARIRP. Gjetet në:

[http://www.sep.gov.mk/data/file/PARIRP/%D0%9F%D0%BB%D0%B0%D0%BD%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%B0%D0%BA%D1%82%D0%B8%D0%B2%D0%BD%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%B8%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%80%D0%B5%D0%B0%D0%BB%D0%B8%D0%B7%D0%B0%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%B8%D1%82%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%B5%20%D1%80%D0%B5%D1%84%D0%BE%D1%80%D0%BC%D1%81%D0%BA%D0%B8%20%D0%BF%D1%80%D0%B8%D0%BE%D1%80%D0%B8%D1%82%D0%B5%D1%82%D0%B8%202015%20\(%D0%A0%D0%B0%D0%B1%D0%BE%D1%82%D0%B5%D0%BD%20%D0%B4%D0%BE%D0%BA%D1%83%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%82\).pdf](http://www.sep.gov.mk/data/file/PARIRP/%D0%9F%D0%BB%D0%B0%D0%BD%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%B0%D0%BA%D1%82%D0%B8%D0%B2%D0%BD%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%B8%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%80%D0%B5%D0%B0%D0%BB%D0%B8%D0%B7%D0%B0%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%B8%D1%82%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%B5%20%D1%80%D0%B5%D1%84%D0%BE%D1%80%D0%BC%D1%81%D0%BA%D0%B8%20%D0%BF%D1%80%D0%B8%D0%BE%D1%80%D0%B8%D1%82%D0%B5%D1%82%D0%B8%202015%20(%D0%A0%D0%B0%D0%B1%D0%BE%D1%82%D0%B5%D0%BD%20%D0%B4%D0%BE%D0%BA%D1%83%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%82).pdf)

Avokati i Popullit i RM-së, 2016. Raporti vjetor mbi shkallën e sigurimit të respektimit, përparimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në vitin 2015. Gjetet në:

http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2015/GI_2015-za_pecat.pdf

Prokuroria Publike Speciale, 2016. Raporti mbi aktivitetet Prokurorisë Publike për Ndjekjen e Veprave Kriminale që lidhen me përmbajtjen dhe dalin nga përmbajta e ndjekjes joligjore të komunikimeve për periudhë prej gjashtë muajsh (për periudhën nga 15.09.2015 deri më 15.03.2016). Gjetet në:

<http://www.jonsk.mk/%D0%B4%D0%BE%D0%BA%D1%83%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%82%D0%B8/>

■ Web-faqet e përdorura:

Institucione

Gjykata Kushtetuese e RM-së: www.ustavensud.mk

Gjykata Supreme e RM-së: www.vsrn.mk

Prokuroria Publike Speciale: www.jonsk.mk

Këshilli Gjyqësor i RM-së: www.ssrn.mk

Prokuroria Publike i RM-së: www.jorm.mk

Gjykata Themelore Shkup 1 Shkup: www.osskopje1.mk

Kuvendi i RM-së: www.sobranie.mk

Qeveria e RM-së: www.vlada.mk

Sekretariati për Çështje Evropiane: www.sep.gov.mk

Sekretariati për Zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit: www.siofa.gov.mk

Ministria e Drejtësisë: www.pravda.gov.mk

Avokati i Popullit i RM-së: www.obmudsman.mk

Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale e RM-së: www.avmu.mk

Këshilli për Etikë në Media në Maqedoni: www.semm.mk

Platforma

MEPLЦ: www.merc.mk

Платформата за родова еднаквост: <http://rodovaplatforma.mk/>

Платформа за борба против корупција: www.mcms.org.mk

Media

MIA: www.mia.mk

Telma: www.telma.com.mk

Kurir: www.kurir.mk

Telegraf: www.telegraf.mk